



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Mirditë

Raport Përfundimtar Auditimi Tematik

PRILL 2021



KONTROLI I LARTË I SHITIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

PËRMBAJTJA		
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 3.Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit
II.	Hyrja	1. Objektivi i Auditimit 2. Qëllimi i Auditimit 3. Identifikimi i çështjes 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 5. Përgjegjësitë e audituesve 6. Kriteret e Vlerësimit 7. Standartet e auditimit 8. Metodatat e auditimit 9. Dokumentimi i auditimit
III	Përshkrimi i auditimit	7-46
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	7
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	7-8
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimt). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	7-8
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	9
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	9-38
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërbllimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	38
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	39
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	46
IV.	Konkluzioni i Auditimit	46
V.	Gjetje dhe Rekomandime	46-48
VI.	Lista e dokumenteve të auditimit	48



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditim tematik në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim ZVASHK) Mirditë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, përcjellë me shkresën nr. 900/8, datë 19.05.2020. Grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.11.2016 deri më datë 31.12.2019 “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2020”.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim sipas çështjeve respektive të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	A. MASA ORGANIZATIVE Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr.900/8, datë 19.05.2020, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon: Rekomandim 2: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marre masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të bëjë të diferencën dokument-fakt, duke kaluar në pronësi shtet sipërfaqen e tepërt prej 1037 m², në kundërt të vendoset kufizim deri në eliminimin e shkeljeve të konstatuara për pasuritë: volum 7, faqe 204, pasuria nr. 6/29, truall me sipërfaqe 9191 m², e cila mbyllet ndahet në volum 8, faqe 78-80 dhe volum 7, faqe 205, pasuria nr. 6/59, truall me sipërfaqe 7272 m², e cila mbyllet e ndahet në volum 8, faqe 81-83. Rekomandim 4: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas: AMTP-së nr. 85, referencë nr. 0617, AMTP-së nr. 88, referencë nr. 615, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.2004, referencë nr. 0603, referencë nr. 669, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.1993, referencë nr. 580, AMTP-së nr. 61, referencë nr. 632, AMTP-së nr. 62, referencë nr. 0655, ZK 1666, deri në veçimin e regjistrimit në pronësi “shtet”, të sipërfaqes së përfutur padrejtësisht, në zbatim të procedurave të përcaktuara në	14-15	E LARTË	ZVASHK Mirditë në bashkëpunim me DVASHK Lezhë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, për rekomandimet e pazbatuara të marrë masa për zbatimin e tyre, ndërsa për rekomandimet e evidentuara që janë zbatuar pjesërisht apo në proces zbatimi, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	VKM nr. 994, datë 9.12.2015 i ndryshuar. <u>Rekomandim 7:</u> Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e përfituara me AMTP nr. 60, datë 01.02.2002, me posedues Dava Reçi, ZK 1666, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020. <u>Rekomandim 12:</u> Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për saktësimin e sipërfaqeve të pasurive të regjistruara, evidentuara në pasqyrën në pasqyrën nr. 1, më parë se të kryhen transaksione sipas AMTP nr. 20(105) dhe referencës nr. 0039, AMTP 53 -54, AMTP 95 dhe referencës 0092, AMTP 2 dhe referencës 079, AMTP 72 dhe referencës 087, AMTP 66 dhe referencës 086, AMTP 7, AMTP nr. 114 dhe referencës 0191, AMTP 94 dhe sipas AMTP 93, bazuar në VKM nr. 994, datë 09.12.2015. <u>Rekomandim 13:</u> Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, sipas Ln, të evidentuara në pasqyrën nr. 1, për 9 raste me sipërfaqe total 10441 m2, deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor për pasuritë. <u>Rekomandim 44:</u> Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të përfituara me leje legalizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit dhe miratimin e kalimit të pronësisë me VKM dhe vendosjen e marrëdhënieve me truallin përkatës. Brenda muajit Shtator 2020. <u>Rekomandim 48:</u> Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 11 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020. <u>Rekomandim 50:</u> Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 8 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe deri në arkëtimin e detyrimit financiar nga 8 subjektet në vlerën 2,800,000 lekë.			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Mirditë për periudhën 01.01.2016 deri me 31.12.2019, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi, është në nivelin 85%. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 52 masa organizative, 9 masa të ardhura të munguara në vlerën 23,424,200 lekë dhe 2 masa disiplinore (“Vërejtje” dhe “Largim nga puna”). Nga të gjitha masat janë pranuar vetëm masat organizative dhe të ardhura të munguara (në total 61).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 52 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 40 rekomandime, zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, në proces zbatimi 3 rekomandime, janë ezauruar si pasojë e ndryshimeve ligjore 3 rekomandime, si dhe janë pazbatuar 5 rekomandime.

Për të ardhura të munguara janë lënë 9 rekomandime në vlerën 23,424,200 lekë (pranuar të gjitha për të cilat janë vendosur kufizimet përkatëse, por nuk është likujduar detyrimi nga asnjë subjekt). Janë lënë 2 masa disiplinore të cilat nuk janë zbatuar nga Drejtori i Përgjithshëm ASHK asnjë prej tyre.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Mirditë (në vijim ZVASHK) “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e vitit 2020”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr.260/4, datë 12.02.2021, auditimi u krye nga audituesi S. Z.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

Titulli

Raport Përfundimtar mbi auditimin tematik, mbi verifikimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2020 të kryer në ZVASHK Mirditë.

Marrësi

ZVASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Ky auditim ka objektiv pasqyrimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm të kryer pranë ZVASHK Mirditë, si dhe dhënien e opinionit objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH në përmirësimin e punës menaxhuese të njësive publike.

Identifikimi i Cështjeve:

ZVASHK Mirditë, si një institucion publik, që është përgjegjës për menaxhimin e fondeve dhe pronës publike me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, ka detyrimin ligjor që të zbatojë rekomandimet e auditimit të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe të informojë këtë të fundit, mbi nivelin pranimit, zbatimit dhe mos zbatimit të tyre.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me cështjen nën auditim

Niveli drejtues i ZVASHK Mirditë, ka detyrimin ligjor për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, duke përgatitur plan-veprimin për zbatimin e tyre, informacionin mbi nivelin e zbatimit, si dhe duke nxjerrë rast pas rasti Urdhëra, Udhëzime, Rregullore, etj., me qëllim argumentimin e zbatimit të rekomandimeve.

Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Raporti Përfundimtar i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Metodat e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Dokumentimi i rezultateve të Auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga akt-verifikimi dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për ridërgimin e rekomandimeve e për përmirësimin e gjendjes.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Ish-ZVRPP Mirditë (ZVASHK Mirditë) është person juridik, publik jobuxhetor, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Ka për detyrë regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe të gjitha ndryshimeve në lidhje me pasuritë e paluajtshme në bazë të kushteve të përcaktuara nga Ligji nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme në rrethën e Mirditës drejtohet nga Regjistruesi. Regjistruesi organizonte dhe drejtonte Ish-ZVRPP Mirditë (nga data 01.04.2019 drejtohet nga Përgjegjësi i ZVASHK Mirditë). Veprimtaria e Ish-ZVRPP Mirditë mbështetet në parimet e sigurisë juridike, transparencës, ligjshmërisë dhe përparësisë në regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Dispozitat e Ligjit nr.33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar dhe ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” zbatohen për periudhën objekt auditimi për regjistrimin e të gjitha pasurive të paluajtshme që shtrihen brenda territorit (juridiksionit) të Rrethit Mirditë, bazuar në aktet e fitimit të pronësisë apo krijimit të të drejtave reale mbi to, sipas kërkesave të paraqitura nga persona juridikë/fizikë, vendas apo të huaj.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1.Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 900/8, datë 19.05.2020, ka dërguar në ZVASHK Mirditë (në vartësi të DVASHK Lezhë) dhe me shkresë 900/7, datë 19.05.2020 ka dërguar në DVASHK Lezhë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga ZVASHK Mirditë janë pranuar të gjitha rekomandimet, është hartuar planveprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe shoqëruar me urdhrin nr. 54, datë 11.06.2020 e Drejtorit të DVASHK Lezhë është përcjellë në KLSH me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020. Shkresa është përcjellë me disa ditë vonesë për shkak të pandemisë së Covid-19 e për pasojë ky detyrim ligjor i kërkuar nga neni 15, gërma e Ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, do të konsiderohet u ezauruar.

-ZVASHK Mirditë, me anë të shkresës nr. 184, datë 11.02.2021, ka përcjellë në KLSH informacion për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, rreth 1 muaj me vonesë, pa respektuar afatin prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH të zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2.

Niveli i pranimi dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 900/8, datë 19.05.2020 janë lënë 63 rekomandime gjithsej, nga këto: 52 masa organizative, 9 masa të ardhura të munguara në vlerën 23,424,200 lekë dhe 2 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 52 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 40 rekomandime, zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, në proces zbatimi 3 rekomandime, janë ezaauruar si pasojë e ndryshimeve ligjore 3 rekomandime, si dhe janë pazbatuar 5 rekomandime.

Për të ardhura të munguara janë lënë 9 rekomandime në vlerën 23,424,200 lekë (pranuar të gjitha për të cilat janë vendosur kufizimet përkatëse, por nuk është likujduar detyrimi nga asnjë subjekt).

Janë lënë 2 masa disiplinore të cilat nuk janë zbatuar nga Drejtori i Përgjithshëm ASHK asnjë prej tyre.

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej në numër	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Ne proces			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr. per	Lekë	Nr. per	Në mijë/lek	Nr . Pers	Në mijë/lek	Nr . pers	Lekë
1.	Masa organizative	52	40	1	3	-	-	-	-	-	-	-	-
2	Shpërblim demi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
3	Të ardhura të munguara	9	-	-	-	-	23,424,200		-	-	-	-	23,424,200
4	Masa disiplinore	2	-	-	-	2	-	-	-	-	-	-	-
	Totali	63	40	1	3	-	23,424,200	-	-	-	-	-	23,424,200

2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësimin në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjorë atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.

1-Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 5 raste, sipas referencave nr. 5780, nr. 5447, nr. 5308, nr. 5862, nr. 5782, ZK 3224, ka kryer veprime dhe ka ofruar shërbimin e kërkuar, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi dokumentacioni i origjinës së fitimit të pronësisë (Vendimi i KKKP-së përkatës), nuk është origjinal, por fotokopje i pa noterizuar, me mungesë të elementeve të formës dhe përmbajtjes dhe të pa konfirmuar nga institucioni që e ka lëshuar aktin administrativ



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

(ATP), si dhe janë hequr kufizimet mbi këto pasuri, në kushtet e mos plotësimit të kërkesave, për të cilat ishte vendosur kufizimi, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar (Trajtuar ne faqe 8-13, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 1: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë: nr. 6/23, volum 7, faqe 42, në emër të bashkëpronarëve trashëgimtarëve të K. Gj. K., pasuria nr. 4/124, volum 6, faqe 226 dhe pasuria nr. 4/133, volum 7, faqe 70, në emër të Z. T., pasuria nr. 3/6, volum 9, faqe 105, trualli me sipërfaqe 960 m², për 4 bashkëpronarë, trashëgimtarë të N. M. P., në volum 5, faqe 131, pasuria nr. 5/108-Nd, për Gj. K., volum 6, faqe 77, pasuria nr. 5/93, trualli me sipërfaqe 2021 m² në emër të bashkëpronarëve trashëgimtarët e M. K., ZK 3224, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor, të konstatuar me parregullsi.

Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë dhe është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 54,56,57 dhe nr. 58, datë 29.12.2020** dhe regjistruar në KPP cituar më sipër.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2-Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 1 rast, me referencë nr. 3336, ZK 3224, ka kryer veprime dhe ka ofruar shërbimin e kërkuar, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi pasuritë e përfituara nga ndarja e pasurive nr. 6/29, volum 7, faqe 204 dhe nr. 6/59, volum 7, faqe 205, rezultojnë në kushtet e kufizimit, për shkak të diferencës dokument –fakt, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së, janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie në kushtet e kufizimit, gjithashtu nuk është ndarë e kaluar në pronësi “shtet” sipërfaqja e tepërt prej 1037 m²(881+156), sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar ne faqet 8-13, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 2: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marre masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të bëjë të diferencën dokument–fakt, duke kaluar në pronësi shtet sipërfaqen e tepërt prej 1037 m², në kundërt të vendoset kufizim deri në eliminimin e shkeljeve të konstatuara për pasuritë: volum 7, faqe 204, pasuria nr. 6/29, truall me sipërfaqe 9191 m², e cila mbyllet ndahet në volum 8, faqe 78-80 dhe volum 7, faqe 205, pasuria nr. 6/59, truall me sipërfaqe 7272 m², e cila mbyllet e ndahet në volum 8, faqe 81-83.

Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është veçuar e regjistruar “Shtet” sipërfaqja tepërt prej 1037 m² në KPP nr., v, f., zk 3224 Qytet Rrëshen bazuar në deklaraten noteriale nr. 621 rep. Nr.250 kol datë 23.6.2020 **urdhër kufizimi nr. 55 datë**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

29.12.2020 dhe regjistruar kufizim në KPP pas.6/93, v.8,f 79 ZK 3224 Rrëshen Qytet cituar më sipër.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces zbatimi.

3- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 4 raste, sipas referencave: nr. 630, nr. 639, nr. 687, dhe nr. 625, ZK 1666, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme truall+ndërtesë në zona urbane të fshati, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi mungon dokumenti ligjor “Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive”, që shërben si akt administrativ për fitimin e pronësisë, duke regjistruar në total truallin me sipërfaqe 1200 m² dhe ndërtesa me sipërfaqe totale 255 m², sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 432, datë 14.08.1995 “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, i shfuqizuar dhe Urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 411, datë 14.05.2013 (Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 3: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për në 4 rastet e sipërcituara dhe në të gjitha rastet e ngjashme, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë janë nxjerrë 3 urdhëra kufizimesh me nr. 60,61,62 dhe nr.63, datë 29.12.2020 dhe regjistruar kufizimet në KPP sipas referencave: nr. 630, nr. 639, dhe nr. 625, ZK 1666; ndërsa nr. 687, ka qenë përfshirë në listën e trojeve.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

4- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 7 raste, sipas referencave nr. 617, nr. 615, nr. 603, nr. 669, nr. 580, nr. 0632, nr. 0655 ZK 1666, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi është regjistruar një sipërfaqe toke në total prej 21000 m², më tepër se sipërfaqja takuese sipas AMTP-ve përkatëse, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25 dhe pikën 2 neni 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) (Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 4: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas: AMTP-së nr. 85, referencë nr. 0617, AMTP-së nr. 88, referencë nr. 615, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.2004, referencë nr. 0603, referencë nr. 669, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.1993, referencë nr. 580, AMTP-së nr. 61, referencë nr. 632, AMTP-së nr. 62, referencë nr. 0655, ZK 1666, deri në veçimin e regjistrimit në pronësi “shtet”, të sipërfaqes së përfutur padrejtësisht, në zbatim të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 994, datë 9.12.2015 i ndryshuar.

Brenda muajit Shtator 2020.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr.1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë pas pranimit të rekomandimeve janë draftuar rreth 80 urdhër kufizime pasurish deri datë 27.8.2020, të rekomanduara nga KLSH lidhur me regjistrimet e pasurive tokë bujqësore përfituar me AMTP (për rekomandimet nr. 4,5,6,7,11,12 dhe nr. 13). Këto urdhër kufizime të draftuara nuk janë ekzekutuar në KPP për shkak të përkimit në kohë të daljes dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 9, pika 1 ku shprehet: “AMTP-të që janë regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk shqyrtohen nga ASHK-ja sipas parashikimeve të nenit 7 të tij. Përfituesit e titujve të regjistruar disponojnë lirisht pasuritë, përveç rasteve të mbivendosura, të cilat nuk mund të zgjidhen sipas nenit 65 të këtij ligji dhe kreut VI të ligjit për Kadastrën, zgjidhen gjyqësisht”.

Gjithashtu me VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 “Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shitesë e pronat shërbyese” kapitulli V, “AMTP të regjistruara para hyrjes në fuqi të ligjit 20/2020” neni 30 ku shprehet AMTP e regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi në regjistrat hipotekor apo të pasurive të paluajtshme shqyrtohen vetëm nesh kanë disponuar mbi pronën publike të pa tjetërsueshme (shënimi im sikundër përcaktuar për zërat kadastral: truall, vepër infra publike, rërë bregdetare plazhi, dhe sipërfaqe ujore)”.

Koment:

Rekomandimi konsiderohet i pranuar, por i pazbatuar.

5- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 4 raste, sipas referencave: nr. 0719, nr. 0689, nr. 6430 dhe 0655, ZK 1666, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, dhe ndarë tokë në mënyrë të pa barabartë, për rrjedhojë nga regjistrimi i tyre, kanë përfituar më tepër në total tokë me sipërfaqe 75200 m2, se sipërfaqja takuese sipas normës për frymë, bazuar në përbërjen familjare me datë 01.08.1991, sa vepruar në papajtueshmëri me pikën 2 neni 3, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe në pikën 2, të VKM-së nr. 255 “Për Kriteret e ndarjes së tokës”, e ndryshuar, për sa i përket regjistrimit të pasurive tokë bujqësore të ndara me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar (Trajtuar në faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 5: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 4 rastet e sipërcituara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe të dërgojë AMTP-të përkatëse, për vlerësim dhe shqyrtim ligjor nga institucionet përkatëse kompetente. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Idem si tek nr.4

Koment:

Rekomandimi konsiderohet i pranuar, por i ezauruar.

6- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 4 raste sipas referencave: nr. 630, nr. 639, nr. 687, ZK 1666 dhe nr. 625, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi Aktet e Marrjes së Tokës në Përdorim, që kanë shërbyer për regjistrimin e pasurive tokë bujqësore me sipërfaqe totale 26800 m2, nuk përmbushin elementet e formës dhe të përmbajtjes të Aktit Administrativ, për të shërbyer si Titull Pronësie(që



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

duhet të jetë Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi), ndërsa ish ZVRPP Mirditë ka vepruar duke regjistruar pasuritë sipas AMT në Përdorim dhe nuk i ka kërkuar Komisionit Vendore të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të këtyre akteve.

Veprime dhe mosveprime në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, me pikën 5, të nenit 45, të nenit 56, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenin 4, të ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore” dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 6: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për rastet e sipërcituara, që ju përkasin referencat nr. 610, nr. 669 dhe nr. 623 (pasuria e regjistruar me referencën nr. 694, rezulton e tjetërsuar tek persona të tretë), deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe konfirmimin nga strukturat kompetente për vlefshmërinë ligjore të këtyre akteve. Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Idem si tek nr.4,5

Koment:

Rekomandimi konsiderohet **i pranuar, por i ezauruar.**

7- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 1 rast, ka regjistruar pasuri të paluajtshme dhe ka kryer transaksione, në favor të poseduesit të AMTP-së me referencë nr. 0599, zk 1666, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi rezulton se AMTP-ja nr. 60, datë 01.02.2002, me posedues D. R., është fotokopje dhe nuk plotëson elementet e formës dhe përmbajtjes të aktit administrativ, ndërsa ZVRPP Mirditë nuk duhet të procedonte me kryerjen e veprimeve duke lëshuar dokument pronësie, por duhet ti drejtohej DAMT pranë Këshillit të Qarkut Lezhë, për të konfirmuar apo lëshuar dublikatë të AMTP-së, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM Nr. 2, datë 13.06.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (amtp)”, pikën 2.2, germa ç, të UKM Nr. 994, datë 9.12.2015 (*Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 7: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e përfituara me AMTP nr. 60, datë 01.02.2002, me posedues Dava Reçi, ZK 1666, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Idem si tek nr.4

Koment:

Pra rekomandimi nr.7 konsiderohet **i pranuar, por i pazbatuar**

8- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë sipas referencës nr. 0597, ZK 1666, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme nr. 278/7, volum 3, faqe 207, truall me sipërfaqe 300 m2, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi rezulton e çregjistruar nga KPP pasuria “shtet” ndërtesë me sipërfaqe 120 m2 duke fshirë të drejtën reale mbi këtë pasuri, gjithashtu regjistrimi i truallit është bërë në mungesë të aktit administrativ për fitimin e pronësisë, pasi AMTP nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie për regjistrimin e truallit, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

dhe pikën 3 neni 34, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 8: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 278/7, volum 3, faqe 207, ZK 1666, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe që argumenton fshirjen e pasurisë “shtet” ndërtesë me sipërfaqe 120 m². Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 64, datë 29.12.2020** dhe regjistruar kufizimet në KPP nr. 278/25, v. 5, f. 56 zk 1666, ardhur me origjinë nga volum 3, faqe 207, ZK 1666.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

9- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë sipas referencës nr. 728, ZK 1666, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme nr. 81/13, volum 4, faqe 43, truell me sipërfaqe 629 m², duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi AMTP nuk është origjinale, duke mos përmbushur elementët e formës dhe përmbajtjes, gjithashtu AMTP nuk mund të shërbejë si Titull Pronësie për regjistrimin e truallit, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenin 2, të ligjit nr. 9948, datë 7.07.2008 “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe ligjin nr. 7501, 19.07.1991, i ndryshuar, dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 9: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 81/13, volum 4, faqe 43, ZK 1666, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 65, datë 29.12.2020** dhe regjistruar kufizimet në KPP nr. 81/13, volum 4, faqe 43, ZK 1666

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

10- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë, në shumë raste, ka regjistruar pasuri të paluajtshme sipas AMTP-ve, duke kryer veprime mbi këto pasuri, në mungesë të dokumentacionit teknik ligjor, pasi mungon certifikata e përbërjes së trungut familjar me datë 01.08.1991, veprim në papajtueshmëri me germën “d” pika 1, të UKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për Procedurën e Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) (Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 10: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në vijimësi të mos kryhen veprime mbi pasuritë e përfutur me AMTP, kur konstatohet se si pjesë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

dokumentacionit mungon certifikata e përbërjes së trungut familjar me datë 01.08.1991, në zbatim të procedurave sipas UKM nr. 994, datë 9.12.2015.

Në vijimësi.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër nr. 66, datë 29.12.2020 i posaçëm ku specifikohet kërkitimi i certifikatës 1 gusht 1991 edhe kur mbi këto pasuri janë kryer veprime të mëparshme si dhe duke vepruar sipas legjislacionit të ri përmendur tek rekomandimi nr. 4.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar** dhe **i zbatuar në vazhdimësi**.

11- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë nuk ka krijuar një bashkëpunim të plotë dhe komunikim të vazhdueshëm ndërmjet ish ZVRPP dhe Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Prefekti Qarkut Lezhë, për rrjedhojë nuk ka informacion të plotë, lidhur me procedurën e ndjekur për shqyrtimin e vlerësimit të ligjshmërisë së AMTP-ve, deri në përfundim të procesit. Gjithashtu nuk është vendosur kufizim në KPP, apo shënim i veçantë (seksionin përkatës), gjatë fillimit dhe zbatimit të procedurave të shqyrtimit të verifikimit, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", neni 74 dhe nenet 45, 59 neni 60, me Ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", të ndryshuar (Trajtuar në faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 11: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa për të rritur bashkëpunimin, duke kërkuar informacion të vazhdueshëm nga institucionet përkatëse që kanë në kompetencë shqyrtimin e vlerësimit të ligjshmërisë së AMTP-ve, si dhe të kufizohen veprimet për pasuritë e përfituara me AMTP, të cilat janë në proces shqyrtimi, deri në përfundimin e këtij procesi. Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Idem si tek nr. 4,5,6,7

Koment:

Rekomandimi konsiderohet **i pranuar**, por **i ezauruar** si pasojë e ndryshimeve ligjore.

12- Gjetje: Nga ish-ZVRPP Mirditë në 10 raste të evidentuara në pasqyrën nr. 1 (bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit), janë regjistruar dhe kryer veprime për pasuri të regjistruara sipas AMTP nr. 20(105) dhe referencës nr. 0039, AMTP 53 -54, AMTP 95 dhe referencës 0092, AMTP 2 dhe referencës 079, AMTP 72 dhe referencës 087, AMTP 66 dhe referencës 086, AMTP 7, AMTP nr. 114 dhe referencës 0191, AMTP 94 dhe sipas AMTP 93, por nuk janë zbatuar kriteret ligjore, pasi nuk janë bërë më parë diferencat LN-AMTP dhe ka rezultuar një sipërfaqe më e madhe se ajo e evidentuar me LN prej 43298 m², që evidenton mos rakordimin dhe saktësimin e pasurive sipas listave të printimit III dhe AMTP. Për sipërfaqet e përfituara dhe të regjistruara në këto 10 raste nuk rezulton të jenë bërë më parë veprimet e saktësimit të pasurive të dokumentuar me plane rilevimi dhe relacione përkatëse e përshtatur me sipërfaqen faktike, në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 dhe udhëzimin nr. 1215, datë 13.11.2012. "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 76, datë 13.09.1999, "Për plotësimin e KPP" (Trajtuar në faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 12: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për saktësimin e sipërfaqeve të pasurive të regjistruara, evidentuara në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

pasqyrën në pasqyrën nr. 1, më parë se të kryhen transaksione sipas AMTP nr. 20(105) dhe referencës nr. 0039, AMTP 53 -54, AMTP 95 dhe referencës 0092, AMTP 2 dhe referencës 079, AMTP 72 dhe referencës 087, AMTP 66 dhe referencës 086, AMTP 7, AMTP nr. 114 dhe referencës 0191, AMTP 94 dhe sipas AMTP 93, bazuar në VKM nr. 994, datë 09.12.2015.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Idem si tek nr.4,5,6,7,11

Koment:

*Pra rekomandimi nr. 12, konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar***

13- Gjetje:Nga ish-ZVRPP Mirditë në 9 raste të evidentuara në pasqyrën nr. 1, (bashkëlidhur këtij Raportit Përfundimtar të Auditimit), rezultojnë të jenë regjistruar pasuri të përfituara sipas LN dhe jo sipas dokumentacionit ligjor AMTP fakt(arkiva e ZVRPP), për rrjedhojë subjektet poseduese të AMTP-ve kanë përfituar sipërfaqe më tepër në total 10441 m2,përkatësisht sipas AMTP 95 800 m2, sipas AMTP 66 222 m2, sipas AMTP 7 1339 m2, sipas AMTP 6 1081 m2, sipas AMTP 114 dhe ref. 0191 272 m2, sipas AMTP 94 946 m2, sipas referencës nr. 0074 1441m2, sipas AMTP nr. 55-dhe 64 për diferencën e përfituar sipas LN për 574 m2 dhe sipërfaqen 1201 m2 përfituar me AMTP 64, dhe sipas referencës 0072 për sipërfaqen 2565 m2 përfituar me LN dhe jo sipas dokumentacioni t ligjor AMTP, veprime në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 dhe udhëzimin nr. 1215, datë 13.11.2012. “ Për një ndryshim në udhëzimin nr. 76, datë 13.09.1999, “Për plotësimin e KPP” *(Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 13: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, sipas Ln, të evidentuara në pasqyrën nr. 1, për 9 raste me sipërfaqe total 10441 m2, përkatësisht sipas AMTP 95 800 m2, sipas AMTP 66 222 m2, sipas AMTP 7 1339 m2, sipas AMTP 6 1081 m2, sipas AMTP 114 dhe ref. 0191 272 m2, sipas AMTP 94 946 m2, sipas referencës nr. 0074 1441 m2, sipas AMTP nr. 55-dhe 64 për diferencën e përfituar sipas LN për 574 m2 dhe sipërfaqen 1201 m2 përfituar me AMTP 64, dhe sipas referencës 0072 për sipërfaqen 2565 m2 përfituar me LN dhe jo sipas dokumentacioni t ligjor AMTP, deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor për pasuritë.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Idem si tek nr. 4,5,6,7,11,12

Koment:

*Rekomandimi nr. 13, konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar***

14- Gjetje:Nga ish-ZVRPP Mirditë në 2 raste, janë regjistruar sipas referencës nr. 0048, pasuria 75/2, v. 2, faqe 207 sipas AMTP nr. 49 me sipërfaqe 2131 m2 në favor të subjektit A. Gj. P. dhe sipas referencës nr. 0050, pasuria nr. 74/2, v2., faqe 210 me sipërfaqe 600 m2, pasuri të cilat i janë shitur subjektit Gj. N. T., janë kryer veprime pa u bërë më parë saktësimi i pasurive, pa pasur plan rilevimi, pa certifikatë familjare të vitit 1991 dhe pa ndonjë dokument konfirmues që këto subjekte janë trajtuar me tokë, dhe nëse janë subjekt i trajtimit nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 08.04.2009, UKM nr. 2, të vitit 2013 dhe pikën 2 të VKM nr. 994, datë 09.12.2015 dhe udhëzimin nr. 1215, datë 13.11.2012. “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 76, datë 13.09.1999, “Për plotësimin e KPP” *(Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi i lënë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Rekomandim 14: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, sipas referencës nr. 0048, nr. 75/2, v.2, faqe 207 sipas AMTP nr. 49 me sipërfaqe 2131 m² në favor të subjektit A. Gj. P. dhe sipas referencës nr. 0050, pasuria nr. 74/2, v.2., faqe 210 me sipërfaqe 600 m² në favor të F. N. P., deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 67,68, datë 29.12.2020 dhe regjistruar kufizimet në KPP pasuria nr. 74/2, v.2., faqe 210, ZK 1121Blinisht.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

15 - Gjetje:Nga ish-ZVRPP Mirditë në 4 raste, janë regjistruar pasuri truall+ ndërtesë, në zonat urbane të fshatit, në mungesë të dokumentacionit ligjor, duke regjistruar truall me sipërfaqe totale 1500 m² dhe ndërtesa me sipërfaqe totale 358 m²(sipas pasqyrës nr. 1 bashkëlidhur), pasi subjektet përfitues të këtyre pasurive nuk rezultojnë të jenë të evidentuar në listat emërore, listat e 001, duke u përfituar padrejtësisht pasuritë me nr. 45/3, v1, faqe 37 dhe 45/5, v1, faqe 236 me sipërfaqe trualli 300 m³ dhe ndërtim 99 secila nga Xh. P. dhe Ll. P. (AMTP-53-54), pasuria nr. 202/4, v.1, faqe 21 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtim 30 m² nga P. B.,(AMTP 95-ref. 092), pasuria nr. 175/1, v.1, faqe 213 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtim 90 m² nga K. M. P. (AMTP 6) dhe pasuria 176/6, v2, faqe 144 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtim 60 m² nga P. Ll. Gj., veprime në kundërshtim me VKM nr. 432, datë 14.08.1995 dhe VKM nr. 159, datë 21.03.2006 (Trajtuar ne faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 15: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, për 4 rastet të evidentuara në pasqyrën nr. 1, për pasuritë nr. 45/3, v1, faqe 37 dhe 45/5, v1, faqe 236 me sipërfaqe trualli 300 m³ dhe ndërtim 99 secila nga Xh. P. dhe Ll. P. (AMTP-53-54), pasuria nr. 202/4, v. 1, faqe 21 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtim 30 m² nga P. B.,(AMTP 95-ref. 092), pasuria nr. 175/1, v.1, faqe 213 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtim 90 m² nga K. M. P. (AMTP 6) dhe pasuria 176/6, v2, faqe 144 me sipërfaqe trualli 300 m² dhe ndërtim 60 m² nga P. Ll. Gj., deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 69, datë 29.12.2020 për 3 pasuritë dhe regjistruar kufizimet në KPP pasuria nr. 198, v. 1, faqe 144 , ZK 1121Blinisht.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

16- Gjetje:Nga ish-ZVRPP Mirditë në 3 raste të evidentuara në pasqyrën nr. 1(bashkëlidhur), rezultojnë të jenë regjistruar pasuri përfituar me leje Legalizimi: sipas referencës nr. 0080, regjistruar pasuria 76/2, v. 3, faqe 7, me sipërfaqe parcele 689.7 m² dhe ndërtim 229.89 m², për subjektin G. K., pasuri e cila i është dhuruar Gj. N. T. sipas KDH nr. nr. 1208/866, datë 30.03.2017 dhe nuk është arkëtuar detyrimi i tatim 15 % për kalimin e pronësisë nga subjekti shitës, në vlerën 156,658 lekë,ndërsa referencës nr. 0082 regjistruar pasuria 49/7, v. 3, faqe 9 me sipërfaqe parcele 1720 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 573m², për subjektin Gj. N. T., rezulton që



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

regjistrimi i truallit është bërë pa miratim me VKM përkatëse. Sipas referencës nr. 0084 janë regjistruar me leje legalizimi 2 ndërtime informale pasuria nr. 49/9-ND v. 3, faqe 12, për 733.6 m² (godinë shërbimi 1 kat) dhe pasuria 49/11-ND v. 3, faqe 15, për sipërfaqen 245 m² godinë shërbimi dhe banimi 2 kat, që janë në pritje të miratimit të truallit me VKM, për të cilat nuk rezultoi të shënime në seksionin E të KPP për truallin në pritje të VKM. Regjistrimi i lejeve të legalizimit është bërë në kundërshtim me pikë 2 të nenit 41, të ligjit nr. 3312, datë 21.03.2012 si pasuri e përfituar gjatë martesës, udhëzimin e KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4, pika 8 për plotësimin e formularit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit.

Gjithashtu rezulton se nga subjekti Gj. N. T. është legalizuar më shumë se një ndërtim informal, në kundërshtim me nenin 25, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, dhe për rrjedhojë këtij subjekti për dy ndërtime informale me sipërfaqe 1223.8 m² duhet ti ishte llogaritur detyrimi me çmime jo favorizuese për taksën e ndikimit në infrastrukturë, por duhet ti ishte llogaritur taksa 4 % kundrejt vlerës për 51,399,600 lekë, që rezulton një detyrim për tu arkëtuar nga subjekti në vlerën prej 2,055,000 lekë (*Trajtuar në faqet 13-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 16: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, të evidentuara në pasqyrën nr. 1, sipas referencës nr. 0080, nga subjekti Gentjan Kola për pasurinë 76/2, v.3, faqe 7, sipas referencës nr. 0080, nga subjekti Gj. N. T. për pasuria 49/7, v. 3, faqe 9 dhe me referencën nr. 0084 janë regjistruar me leje legalizimi 2 ndërtime informale pasuria nr. 49/9-ND v. 3, faqe 12 dhe pasuria 49/11-ND v. 3, faqe 15, deri në plotësimin në dokumentacionit të duhur ligjor duke vendosur shënime në seksionin E për truallin dhe arkëtimin e detyrimeve nga G. K. të tatimit 15% për kalimin e pronësisë në vlerën 156,658 lekë, dhe nga subjekti Gj. N. T. të detyrimit për aplikimin e taksës së ndikimit në Infrastrukturë në vlerën prej 2,055,000 lekë.

Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 70, datë 29.12.2020 për 3 pasuritë dhe regjistruar kufizimet në 3 KPP pasuria nr. 49/7, v. 3, faqe 9, ZK 1121Blinisht., nr.76/2, v.3, faqe 7, dhe nr. 49/9-ND v. 3, faqe 12 ZK 1121Blinisht deri në plotësimin e dokumentit të likuidimit të detyrimeve.

Koment:

*Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar***

17- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka ofruar shërbimin e kërkuar, sipas referencës 0288, ZK 3563, në kushtet kur: të dhënat e aktit (sipërfaqja në m²) janë të korrigjuara dukshëm dhe sipërfaqja e të gjitha pasurive dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në KPP, duke regjistruar më shumë një sipërfaqe prej 3750 m². Në kartelën e pasurisë së paluajtshme (KPP) volum 3, faqe 220, është regjistruar pasuria nr. 394/3, me sipërfaqe 10000 m², e cila mbyllet shkon volum 4 faqe 211 nr. 394/18 me sipërfaqe 34905 m² në emër të Mark Prenga, pasuria me referencë 0125 kalon shtet dhe më pas me referencë nr. 127 kalon në pronësi të A. P., sipas AMTP nr. 209, datë 14.08.2008 në emër të A. P.. Në këto kushte janë kryer veprime duke trajtuar me tokë z. A. P. si kryefamiljar, duke mos qenë subjekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar, pasi sipas gjendjes certifikatës familjare datë 05.02.1992 rezulton pjesëtar i familjes të përberë nga 4 anëtar, të cilët janë trajtuar një herë me tokë sipas AMTP nr. 144, datë 25.06.1993. Gjithashtu nuk përputhen indeksi i hartës në plan rilevimit përcjell nga komuna, me indeksin e hartës në volum dhe indeksin e hartës sipas pozicionimit të pronave në (planshet) harta e punës. ZVRPP-ja. Veprime në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

pasurive të paluajtshme”, pika 2.2, të VKM Nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar në faqet 13-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 17: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë volum 1, faqe 5, pasuria nr. 97/2, volum 1, faqe 6, nr. 96/2, volum 4, faqe 210, pasuria nr. 394/17, volum 3, faqe 220, pasuria nr. 394/3, ZK 3563, Referencë nr. 0288, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 71, datë 29.12.2020 për pasurinë e mësipërme dhe regjistruar kufizime përkatëse për të cilat do të vazhdojë trajnimi sipas legjislacionit të ri.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

18- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka ofruar shërbimin e kërkuar, sipas referencës 00298 ZK 3563, në kushtet kur: Të dhënat e aktit (sipërfaqja në m2) janë të korrigjuara dukshëm. sipërfaqja e të gjitha pasurive, dhënë me AMTP, del e ndryshme nga sipërfaqja e regjistrimit fillestar të këtyre pasurive, e pasqyruar në kartelat e tyre respektiv, duke regjistruar në kartela më shumë një sipërfaqe prej 1000 m2. Veprime në papajtueshmëri me shkronjën “e” neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 2.2, të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”. Pika 2 paragrafi 2 i UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar në faqet 13-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 18: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 97/1, volum 2, faqe 233, ZK 3536, Referencë nr. 0298, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 72, datë 29.12.2020 për pasurinë e mësipërme dhe është regjistruar në KPP nr.97/1,v.2,f.233, zk 3563 Tarazh.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

19- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 3 raste, sipas referencave nr. 3336, nr. 5602 dhe nr. 5486 ZK 3224, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme dhe ka kryer veprime për këto pasuri, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi janë hequr kufizimet, pa u korrigjuar parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara më parë, të llojit “mungon dosja e privatizimit, mungon marrëdhënia me truallin. Ka diferencë –fakt”, “dokumentacioni i privatizimit nuk është origjinal”, etj, ndërsa nga punonjësit e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

ZVRPP-së nuk duhet të kryheshin veprime, duke lëshuar certifikatë pronësie, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar ne faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 19: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë: nr. 2/76-N1, volum 8, faqe 110, nr. 2/76-N2, volum 8, faqe 111, sipas referencës nr. 3336, pasurinë nr. 2/96-N1, volum 9, faqe 53, sipas referencës nr. 5486, pasuria nr. 5/190, volum 6, faqe 79, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 74, datë 29.12.2020 për pasuritë e mësipërme dhe nga verifikimi me zgjedhje është regjistruar në KPP nr. 2/76-N2, volum 8, faqe 111, dhe KPP nr. 2/96-N1, volum 9, faqe 53 zK ZK 3224, Rrëshen Qytet.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

20- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 1rast, sipas referencës nr. 5322, ZK 3224, ka regjistruar dhe ka kryer veprime pasurinë e paluajtshme nr. 8/334, volum 5, faqe 89, e cila nga poseduesi, ka kaluar në pronësi të Agjencisë së trajtimit të Kredive, për shkak të detyrimit të pashlyer ndaj shtetit, në shumën 2.299.000 lekë, si kredimarrës, që rezulton me shkelje dhe parregullsi, pasi mungon dokumentacioni i privatizimit që përmbush kërkesat për të shërbyer si akt administrativ, gjithashtu kontrata e shitjes nuk ka formën ligjore të kërkuar, trulli është regjistruar në mungesë të dokumentacionit që shërben si Titull Pronësie, kjo e konstatuar edhe gjatë regjistrimit fillestar, për të cilën është vendosur kufizim mbi këtë pasuri, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së janë kryer veprime në kushtet e kufizimit, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar ne faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 20: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, të rivlerësojnë dokumentacionin e origjinës së pronës, si për objektin ndërtesë, ashtu edhe për truallin, duke kërkuar nga palët korrigjimin e parregullsive, lidhur me plotësimin e dokumentacionit teknik ligjor të origjinës së pronës.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 75, datë 29.12.2020 për pasuritë e mësipërme deri ne paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

21- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 1 rast, sipas referencës nr. 3542, ZK 3224, ka regjistruar dhe ka kryer veprime mbi pasuritë, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi duke ju referuar dokumentacionit ligjor dhe hartografik të privatizimit, për 4 pasuritë janë regjistruar sipërfaqe ndërtimi prej 91.5 m² (13+6.5+46+26, më tepër se dokumenti ligjor. Gjithashtu regjistrimi i truallit me sipërfaqe 1061.5 m², është bërë në mungesë të dokumentacionit ligjor që shërben si Titull Pronësie, ndërsa nga punonjësit e ZVRPP-së janë kryer veprime, duke lëshuar certifikatë pronësie në kushtet e kufizimit, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit” (Trajtuar ne faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 21: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 6/31, volum 5 faqe 71 truall me sipërfaqe 219.5 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 219.5 m²; nr. 6/10, volum 5 faqe 72 truall me sipërfaqe 302 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 302 m²; nr. 6/12, volum 5 faqe 73, truall me sipërfaqe 361 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 361 m², ; nr. 6/8, volum 5 faqe 74 truall me sipërfaqe 179 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 179 m², ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor, në referencë të këtij dokumentacioni do të kërkohet shlyerja e detyrimit për qiranë e përdorimit të truallit. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 76, datë 29.12.2020 për pasuritë e mësipërme deri ne zgjidhjen e plotë veprimeve saktësuese mbi këto pasuri për të cilat është vendos kufizimi.**

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

22- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 1 rast, sipas referencës nr. 5805, ZK 3224, ka regjistruar dhe ka kryer veprime pasurinë e paluajtshme nr. 6/131, volum 5, faqe 68, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi regjistrimi i truallit më sipërfaqe 512 m², ka pasaktësi dhe paqartësi lidhur me vlefshmërinë ligjore, të dokumentacionit që ka shërbyer për regjistrimin e pronës, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012, pikën 7, kreu IV, rregullores nr. 184, datë 08.04.1999, “Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” (Trajtuar ne faqet 52-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 22: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 6/131, volum 5, faqe 68, ZK 3224, sipas referencës nr. 5805, deri në konfirmimin zyrtar nga institucionet përkatëse, lidhur me vlefshmërinë ligjore të dokumentacionit që ka shërbyer për regjistrimin e truallit me sipërfaqe 512 m². Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër me rezervë nr. 77, datë 29.12.2020 për pasurinë e mësipërme deri në saktësim të dokumentacionit dhënë më 22.06.1994.**

Koment:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

23- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 1rast, sipas referencës nr. 5651, ZK 3224, ka regjistruar dhe ka kryer veprime mbi pasuritë, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi duke ju referuar dokumentacionit ligjor dhe hartografik të privatizimit, është regjistruar sipërfaqe ndërtimi prej 32 m2, më tepër se dokumenti ligjor. Gjithashtu janë kryer veprime, duke kryer transaksion mbi pasurinë në kushtet e kufizimit, vepruar në papajtueshmëri me nenin 24/a, të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, me nenin 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit" (Trajtuar në faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 23: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/52+Nd-N3, volum 7 faqe 100, njësi me sipërfaqe 118.5 m2, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 78, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme nr. 2/52+Nd-N3, volum 7 faqe 101 ZK 3224, deri në zgjidhjen e plotë të veprimeve saktësuese Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

24- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka ofruar shërbimin e kërkuar duke kryer veprime në regjistrat e pasurive të paluajtshme në kushtet kur: Subjektet e interesuara për kryerjen e këtyre veprimeve nuk janë autorizuar nga asnjë ent apo institucion përgjegjës që administron këto pasuri, është bërë ndryshimi i llojit të pasurisë nga lumë në truall, pasuri të cilat janë të pa tjetërsueshme dhe nuk i nënshtrohen asnjë lloji regjimi juridik tjetërsimi. Dokumentacioni në dosje nuk është origjinal. Nuk ka procedurë ligjore nga Ministria dhe autoritetet e planifikimit përkatës, që mbulon veprimtarinë që lidhet me këto kalime apo ndryshime të kategorisë së resursit, ku DAMT bën koordinimin e veprimeve deri në daljen e akteve nënligjore, e cila njofton ZVRPP ku të pasqyrojë ndryshimet për llojin e pasurive, sipas pronarëve ose poseduesve të ligjshëm të tyre. Veprime këto në papajtueshmëri me shkronjat "ç", "e", neni 20, shkronjën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, me pikat 1, 2, 3, 4 kreu I dhe kreu VIII të Vendimit nr. 410, datë 27.06.2012 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës", pikat 5.1, kreu VI të Rregullores Nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", e ndryshuar (Trajtuar në faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 24: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë volum 2 faqe 95 dhe volum 2 faqe 161 dhe pasurinë volum 2 faqe 162 nr. 193 ZK 2162, Referencë nr. 0116, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 79, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë volum 2 faqe 162 nr. 193 ZK 2162, ardhur nga dy pasuritë e tjera deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

25- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka kryer regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, në kushtet e mungesës së kontratës së përdorimi "tip userfrukt", të lidhur ndërmjet bashkimit të operatorëve "Gloris constuction" shpk dhe "Gjoka Construction" shpk, dhe autoritetit kontraktues lidhur me sheshin e ndërtimit mbi pronë shtetërore, nuk janë identifikuar pasuritë e përfshira në sheshin e ndërtimit, pasi nuk kanë përcaktuar zonat kadastrave, numrat e pasurive, sipërfaqen që do të zërë, statusin juridik të pronës, mënyrën e marrëdhënieve që do të krijohen me pronarët e pronave që prek ky objekt, si dhe nuk përputhen sipërfaqet e përcaktuar në lejen e ndërtimit me sipërfaqen e regjistruar (KPP). Në hartën kadastrale me indeks harte K-34-77-(53-A-B) (37C) është hedhur me laps objekti i HEC-it së bashku me linjën e marrjes dhe të shkarkimit, kryesisht në pasurinë nr. 138. Nga verifikimi i gjeoportalit asig.gov.al i cili përmban ortofoton e azhurnuar nga viti 2012 dhe në vijim, si dhe google map, nuk rezulton të jetë ndërtuar asnjë objekt, ndërkohë që është hedhur në planshetë hartë kadastrale, një objekt që nuk ekziston. Në dosje mungojnë: Akti i kolauditimit, Leja e Përdorimit, projekti dhe planvendosja të pa miratuar nga autoriteti përgjegjës. Veprime në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 6 dhe 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me nenin 79 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, me kreun III pikat 4 dhe 4.1.1. të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" (Trajtuar ne faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 25: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 138 volum 2, faqe 157, ZK 2162, Referencë nr. 0113, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 80, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 138 volum 2, faqe 157, ZK 2162, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

26- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka kryer regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, në kushtet e mungesës së kontratës së përdorimi "tip userfrukt", të lidhur ndërmjet koncesionarit "Blaç Energy" shpk dhe autoriteti kontraktues që ka në administrim pronat, nuk janë identifikuar pasuritë e përfshira e përfshira në sheshin e ndërtimit, pasi nuk kanë përcaktuar zonat kadastrave, numrat e pasurive, sipërfaqen që do të zërë, statusin juridik të pronës, mënyrën e marrëdhënieve që do të krijohen me pronarët e pronave që prek ky objekt. Gjithashtu në dosje mungojnë: Leje sheshit Leje ndërtimit Akti i kolauditimit, Leja e Përdorimit, projekti dhe planvendosja të pa miratuar nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

autoriteti përgjegjës. Aktet e paraqitura për regjistrim janë kopje. Veprime në papajtueshmëri me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", nenin 6 dhe 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me nenin 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar, pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, me kreun III pikat 4 dhe 4.1.1. të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" (Trajtuar ne faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 26: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 401, volum 1, faqe 202, ZK. 2327, Referencë nr. 016, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 81, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 401, volum 1, faqe 202, ZK. 2327, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

27- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka kryer regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, në kushtet kur: Nuk përputhen të dhënat e pronës ndërmjet dokumentit të kalimit të pronësi, genplanit të miratuar nga Bashkia dhe (KPP), sipërfaqja e regjistruar dhe numri i pasurisë. Gjithashtu mungon kontrata e qerasë ndërmjet subjektit përfitues dhe Bashkisë (qiradhënësit.) Me vendimin nr. 126 datë 24.10.2018, është vendosur dhënia në përdorim me kontratë qiraje të sipërfaqes 8.349 ha, si dhe raporti teknik pa datë, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit nr. 332, datë 11.10.2018, mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim dhe heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor në administrim të bashkisë Mirditë. Për të cilin nuk ka urdhër të ministrit të linjës, për heqjen nga fondi kullosor, për sipërfaqe deri në 1 ha dhe për sipërfaqe mbi 1 ha, miratim në Këshillin e Ministrave. Veprime në papajtueshmëri Vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, Vendimin nr. 435, datë 8.6.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të këshillit të ministrave, Vendim nr. 592, datë 9.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të këshillit të ministrave, Vendim nr. 1353, datë 10.10.2008 Vendim nr. 434, datë 8.6.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008, të këshillit të ministrave, Vendim nr. 591, datë 9.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008, të këshillit të ministrave, me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, me kreun III pikat 4 dhe 4.1.1. të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme" (Trajtuar ne faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 27: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 140 volum 2, faqe 163, ZK. 2162, Referencë nr. 00117/0118, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 82, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 140 volum 2, faqe 163, ZK. 2162, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

28- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka kryer regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, në kushtet kur: Nuk përputhen të dhënat e pronës, ndërmjet dokumentit të kalimit të pronësisë, genplanit të miratuar nga Bashkia dhe (KPP), nuk përputhen sipërfaqja e regjistruar dhe numri i pasurisë, në kontratën e qerasë, ku rezulton që sipërfaqja 0.777 ha sipas kontratës, ndërsa në kartelë është regjistruar 467.1579 m². Gjithashtu pasuria në fjalë mbivendoset me disa prona të tjera të pasqyruara këto në hartën e punës. Nuk përputhet zëri kadastral në raportin teknik, me atë të pasqyruar në (KPP), pasi në raport është i zërit djerrë/ inproduktive ndërsa në (KPP) është regjistruar pyll, planimetritë bashkëlidhur praktikës kopje të njëjësuar. Me vendimin nr. 40 datë 20.03.2019 është vendosur dhënia në përdorim me kontratë qiraje sipërfaqja 0.777 ha si dhe raporti teknik pa datë në zbatim të urdhrat të kryetarit nr. 96, datë 08.03.2019 mbi studimin tekniko ekonomik për dhënien në përdorim dhe heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor në administrim të Bashkisë Mirditë. “Veprime në papajtueshmëri Vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, Vendim nr. 435, datë 8.6.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të këshillit të ministrave, Vendim nr. 592, datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1374, datë 10.10.2008, të këshillit të ministrave, Vendim nr. 1353, datë 10.10.2008 Vendim nr. 434, datë 8.6.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008, të këshillit të ministrave, Vendim nr. 591, datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në me pikën 1 neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pikën 2 paragrafi 2, të UKM nr. 2, datë 12.09, me kreun III pikat 4 dhe 4.1.1. . të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme” (Trajtuar ne faqet 52-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 28: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 19/15, volum 1, faqe 240, ZK 3721, Referencë nr. 0105, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 83, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 19/15, volum 1, faqe 240, ZK 3721, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.**

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

29-Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit në kushtet kur: Pasuritë në fjalë në hartën e punës mbivendosen me dy objekte të cilat ndodhen të regjistruar më parë, aneksi bashkëlidhur VKM për transferimin e pronave i pa plotë. Veprime këto në papajtueshmëri me “ç”, “e”, neni 20, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar (Trajtuar ne faqet 52-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Rekomandim 29: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 402, volum 1, faqe 203, ZK 2327, Referencë nr. 020, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 84, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme** pasurinë nr. 402, volum 1, faqe 203, ZK 2327, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

30- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 5 raste sipas referencave: nr. 5289, nr. 5438, nr. 5323, nr. 5270, nr. 5413, ZK 3224, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme bazuar në dokumentacionin urbanistik, ku rezulton se regjistrimi është kryer me parregullsi, pasi dokumentacioni ligjor urbanistik nuk është origjinal, por fotokopje i panoterizuar, ka pasaktësi të dhënash, si dhe është kryer në mungesë të marrëdhënieve me truallin. Gjithashtu për pasuritë që ju përkasin referencave nr. 5270 dhe nr. 5413 janë kryer veprime në kushtet kufizimit, vepruar në kundërshtim me shkronjën “a” neni 25, me pikën 2 nenin 45, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, me Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe me germat “a” e “c”, kreu IV, të UKM nr. 1, datë 13.04.2016 (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 30: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi në raste, për pasuritë: nr. 2/25-Nd, volum 13, faqe 54,: nr. 5/190-Nd, volum, faqe 54; nr. 3/222-Nd, volum 10, faqe 130, nr. 2/227-Nd, volum 10, faqe 176; nr. 3/100-Nd, volum 9, faqe 60 ndarë në pasuritë volum 13 nga faqja 114 deri faqe 117 dhe volum 13, nga faqja 111 deri faqe 113, të regjistruara sipas referencave të sipërcituara, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr.1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 85, 86, 87 dhe nr. 88, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasuritë e mësipërme**, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

31- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë ka regjistruar dhe ka kryer veprime sipas referencës nr. 5077, për pasurinë nr. 8/254-Nd, volum 13, faqe 38, bazuar në dokumentacionin urbanistik, regjistrimi është kryer me shkelje e parregullsi, pasi mungon dokumentacioni ligjor, që ka miratuar shtesën anësore duke rritur sipërfaqen e gjurmës së objektit me 58.2 m2, si dhe ka mungesë të dokumentacionit ligjor urbanistik dhe ka pasaktësi, si dhe është kryer në mungesë të marrëdhënieve me truallin, vepruar në kundërshtim me shkronjën “a” neni 25, me pikën 2 nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012, Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 13.04.2016; “Për Caktimin e Kriterëve e të procedurave për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin, në cilësinë e investitorit e të pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njësive individuale, të objektit në fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar” (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 31: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë 8/254-Nd, volum 13, faqe 38, të regjistruar sipas referencës nr. 5077, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 89, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 8/254-Nd, volum 13, faqe 38, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

32- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë në 1 rast sipas referencës nr. 2612, ZK 3224, ka regjistruar pasurinë e paluajtshme bazuar në dokumentacionin urbanistik, ku rezulton se regjistrimi është kryer me parregullsi, pasi dokumentacioni ligjor urbanistik nuk është origjinal, por fotokopje, ndërsa trualli është përfituar me kontratë shitje nga Bashkia Rrëshen, e cila nuk zotëron pronësinë mbi këtë truall. Gjithashtu për këtë pasuri, është hequr kufizimi pa u plotësuar kushtet për të cilat është vendosur kufizimi, vepruar në kundërshtim me shkronjën “a” neni 25, me pikën 2 nenin 45, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 5, të UKM nr.2, datë 12.09.2012, me Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar dhe me germat “a” e “c”, kreu IV, të UKM nr. 1, datë 13.04.2016 (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 32: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 2/214, volum 7, faqe 77, regjistruar sipas referencës 2612, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë sipas informacionit kërkuar me shkresën nr. 2053 datë 22.10.2020, dhe përgjigjur Bashkia Mirditë me shkresën nr.3706, datë 23.10.2020 është sjellë dokumentacioni i plotë.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

33- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë ka regjistruar dhe ka kryer veprime sipas referencës nr. 5859, për pasurinë nr. 8/319, volum 7, faqe 84, bazuar në dokumentacionin urbanistik dhe privatizimi, rezulton që regjistrimi është kryer me shkelje e parregullsi, pasi ka paqartësi dhe mospërputhje të dhënash lidhur me shtesën e sipërfaqes së katit përdhe dhe shtesën e numrit të kateve, projekti i zbatimit rezulton i pa miratuar nga Kryetari i Bashkisë, mungon planimetria e katit përdhe, ndërsa janë kryer veprime dhe është hequr kufizimit pa u plotësuar kushtet për të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

cilat ishte vendosur. Gjithashtu lidhur me truallin e regjistruar është krijuar diferenca prej 24 m2, për të cilën mungon dokumentacioni i pronësisë, sa vepruar në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 33: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë 8/319, volum 7, faqe 84, të regjistruar sipas referencës nr. 5859, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 90, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 8/319, volum 7, faqe 84, ZK 3224, Rrëshen Qytet deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

34- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë ka regjistruar dhe ka kryer veprime sipas referencave nr. 575 dhe 454, për pasurinë nr. 50/22, volum 4, faqe 41, objekti “Kompleks shërbimesh 5 kat+bodrum+karburant”, bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezulton që regjistrimi është kryer me shkelje e parregullsi, pasi ka paqartësi dhe mospërputhje të dhënash lidhur me sipërfaqen e ndërtimit (gjurmës së objektit, konkretisht në aktin e kolaudit, pasqyrohet sipërfaqja e ndërtimit (gjurma) 544.3 m2, ndërsa në KPP volum 4, faqe 229, është regjistruar sipërfaqe të bazës së ndërtimit 582.82 m2 dhe pas bashkimit të objektit me truallin është regjistruar në KPP, sipërfaqja e ndërtimit (gjurma) 642.3 m2, duke krijuar një diferencë prej sipërfaqja e ndërtimit (gjurma) 98 m2, e cila i përket sipërfaqes që zë streha e karburantit (referuar plan vendosjes së miratuar).

Gjithashtu lidhur me truallin e regjistruar, ka paqartësi lidhur me formimin e pasurisë nr. 50/20, pyll sipërfaqe 1272 m2, volum 4. Faqe 228 (përfutur me kontratë shitblerje nga Ministria e Financës), pasi nga ndarja e pasurisë mëmë ” volum 4, faqe 201, e llojit “Pyll” dhe pasurisë volum 1, faqe 175 e llojit “lum”, rezulton që pas ndarjes kemi rritje të pasurisë e llojit “Pyll” dhe zvogëlimin e pasurisë së llojit “lum” për sipërfaqen 175 m2, duke krijuar idenë që kjo sipërfaqe ka kaluar si pjesë e pasurisë 50/20, pyll sipërfaqe 1272 m2, si truall në funksion të objektit (kjo referuar edhe hartës treguese) dhe mungon urdhri i Regjistruarit, apo ndonjë dokument tjetër që ka shërbyer për korrigjimin e sipërfaqeve në KPP.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2 neni 45, nenin 30, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 34: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 50/22, volum 4, faqe 41, të regjistruar sipas referencave nr. 575 dhe 454, deri në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

konfirmimin nga institucionet përkatëse për saktësimin e pasurive që kanë formuar sheshin e ndërtimit (truallin funksional) dhe kofirmimin zyrtar nga Bashkia Mirditë lidhur me saktësimin e sipërfaqes së ndërtimit të objektit (gjurma e ndërtimit). Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë sipas përgjigjes nga Bashkia Mirditë me shkresën nr. 2071, datë 17.8.2020 dhe nr. 2072 datë 26.8.2020 ku konfirmohet pozicionimi i sipërfaqes për gjurmën e objektit dhe të sheshit është sjellë dokumentacioni i plotë.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

35- Gjetje: Nga ish ZVRPP Mirditë me referencë nr. 075, është regjistruar pasuria nr. 75/2, v.2, faqe 207 me sipërfaqe trualli 2131 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 200 m², objekti “Autogril-Kompleks Shërbimesh, Karburant Hoteleri”, bazuar në dokumentacionin urbanistik (leje ndërtimi dhe leje sheshi nr. 1, datë 12.08.2011, rezulton se nuk është bërë llogaritja e taksës së ndikimit në Infrastrukturë 4%, në lidhje me diferencën e vlerës situacionit dhe vlerës së preventivit, për rrjedhojë është krijuar një vlerë e pa arkëtuar në shumën prej 1,097,300 lekë (27,434,400*0.04) (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 35: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruara në emër të Gj. N. T. sipas referencës nr. 0075, të përfituara nga Ligji i Urbanistikes nr. 8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme deri në arkëtimin e detyrimit të përcaktuar nga llogaritja e taksës së ndikimit në Infrastrukture në vlerën prej 1,097,300 lekë. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 91, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 8/319, volum 7, faqe 84, ZK 3224, Rrëshen Qytet deri në plotësimin paraqitjen e dokumentacionit për shlyerjen e taksës së ndikimit në Infrastrukture në vlerën prej 1,097,300 lekë**.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**.

36- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka ofruar shërbimi e kërkuar subjektit në kushtet kur: Nuk përputhen sipërfaqet ndërmjet sheshit ndërtimit dhe (KPP): Sipërfaqja e sheshit në leje 4200 m², ndërsa në (KPP) 3400 m², sipërfaqja e ndërtimit në leje 826 m², ndërsa në (KPP) 127.5 m². Në lejen e sheshit numri maksimal i kateve është 4 ndërsa në projektin e miratuar dhe gjendja faktike paraqiten me 1 kat, pra nuk ka vendim nga autoriteti përgjegjës për ndryshimin e kondicioneve. Në planimetrinë e sheshit të ndërtimit, vendosja e objektit 3 katesh, rezulton që gjysma e tij është pozicionuar jashtë pasurisë nr. 4, duke kaluar në pasurinë nr. 45 e llojit ranishte në pronësi shtet, volum 2 faqe 119. Gjithashtu është shtyrë afati i lejes së ndërtimit jashtë afatit të përfundimit të lejes së parë. Veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45 të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012“, ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Rekomandim 36: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 47/7, volum 3, faqe 59, ZK 1601, Referencë nr. 0263, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 92, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 47/7, volum 3, faqe 59, ZK 1601, deri në plotësimin paraqitjen e dokumentacionit tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

37- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në të gjitha rastet sipas referencave të audituara e të trajtuara, ZK 3224, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme bazuar në Leje legalizimi, ku rezulton se regjistrimi është kryer me parregullsi, pasi për poseduesit e lejeve të legalizimit janë miratuar parcela ndërtimore që rezultojnë si prona të bashkisë, ndërsa mungon dokumentacioni që konfirmon miratimin nga Bashkia Mirditë, si pronare e ligjshme e pasurisë, vepruar në kundërshtim me nenin 15, pika 2, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”, i ndryshuar dhe nenin 45, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (Trajtuar në faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 37: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, që në vijimësi të kërkohet konfirmimi zyrtar nga Bashkia Mirditë, për bërë të mundur vazhdimin e procedurës së legalizimit, për të miratuar kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore përkatëse, për të gjitha rastet kur ato kanë statusin juridik si prona të bashkisë. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e DVASHK Lezhë me Përgjegjësin e ZVASHK Mirditë janë marrë masat që në vijimësi kërkohet konfirmimi zyrtar nga Bashkia Mirditë, për plotësim vazhdimin e procedurës së legalizimit për pasuritë origjinë Lejen e legalizimit të miratuar.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

38- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë, në 1 rast me referencë nr. 5396, ZK 3224, ka regjistruar në volum 13, faqe 83, pasuria nr. 8/341, përfituar me leje legalizimi, e cila nuk është lëshuar në përputhje me përcaktimet ligjore, pasi objekti i legalizuar bie mbi pasurinë shtet të llojit “rrugë”, për sipërfaqen 23 m², ndërsa pjesa tjetër e parcelës ndërtimore, rezulton si prona të bashkisë, ndërsa mungon dokumentacioni që konfirmon miratimin nga Bashkia Mirditë, ndërsa ZVRPP nuk duhet të procedonte me regjistrimin e kësaj pasurie, sa vepruar në kundërshtim me germën “a”, neni 25, pikën 5, neni 44, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 280, datë 01.04.2015 (Trajtuar në faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 38: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 8/341, volum 13, faqe 83, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor apo konfirmimin zyrtar nga institucionet kompetente, që kjo pasuri “rrugë” ka ndryshuar destinacion dhe nuk shërben për interesa publike. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr.900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 93, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme pasurinë nr. 8/341, volum 13, faqe 83, ZK 3224, deri në plotësimin paraqitjen e dokumentacionit tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

39- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 2 raste sipas referencave nr. 5672 dhe nr. 5429, ZK 3224, ka regjistruar përkatësisht, në volum 13, faqe 143, pasuria nr. 8/338, objekti “Godinë shërbimi 1 kat”, me sipërfaqe ndërtimi 28.05 m² dhe truall me sipërfaqe ndërtimi 47 m² ; në volum 13, faqe 96, pasuria nr. 3/229, objekti “Godinë e kombinuar 2 kat+bodrum”, me sipërfaqe ndërtimi 96.5 m² dhe sipërfaqe trualli 103 m², të përfituara me leje legalizimi, ku rezulton se regjistrimi i truallit në të 2 rastet, është kryer në mungesë të dokumentacionit që shërben si Titull Pronësie, pasi nuk janë miratuar me VKM (kjo e konfirmuar edhe nga Drejtoria Vendore e ASHK Lezhë), ndërsa ZVRPP nuk duhet të procedonte me regjistrimin e truallit, sa vepruar kundërshtim me dispozitat ligjore, përcaktuar gjerësisht në “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”, i ndryshuar (Trajtuar në faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 39: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 8/338, volum 13, faqe 143 dhe nr. 3/229, volum 13, faqe 96, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor për fitimin e pronësisë së truallit. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 94, 95, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë e mësipërme nr. 8/338, volum 13, faqe 143 dhe nr. 3/229, volum 13, faqe 96, dhe nr. 3/229, volum 13, faqe 96, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor për fitimin e pronësisë së truallit.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

40- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 1 rast sipas referencës nr. 5776, ka regjistruar pasurinë nr. 6/91-Nd11, ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 286.1 m², volum 13 faqe 173, në bazë të lejes së legalizimit, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi nga verifikimi i dokumentacionit ligjor rezulton se mbi truallin që është ngritur objekti i legalizuar, ka ekzistuar ndërtesa me sipërfaqe 101 m², pasuria nr. 6/91-Nd4, volum 9, faqe 46, në pronësi “shtet”, e cila është fshirë nga regjistrimi në KPP, për këtë veprim nuk disponohet ndonjë akt administrativ të lëshuar nga organet përkatëse, apo vendim gjykatë të formës së prerë, pasi objekti i legalizuar bie mbi një ndërtesë në pronësi shtetet, me sipërfaqe 101 m², sa vepruar në papajtueshmëri me nenin 34, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

ndërtimeve informale”, i ndryshuar (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 40: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të kërkojë konfirmimin nga institucionet përkatëse (Bashkia dhe ALUIZNI), lidhur me gjendjen e objektit të prishur, në periudhën që është ndërtuar objekti i legalizuar. Gjithashtu në vijimësi të mos kryhen regjistrime objektsh të legalizuara që janë ngritur mbi ndërtesa që rezultojnë të regjistruara në KPP, pa u konfirmuar zyrtarisht, me dokumentacionin përkatës për prishjen e objektit. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe në përgjigje kërkesës nr. 2019, datë 16.10.2020 të Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë, Bashkia Mirdite me shkresën nr. 3837, datë 27.10.2020 ka konfirmuar dhe ridërguar dokumentacionin ne lidhje me këtë rekomandim të KLSH.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

41- Gjetje: ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë në 1 rast sipas referencës nr. 5190 ka regjistruar pasurinë nr. 2/188-Nd, “Godinë shërbimi 1 kat” me sipërfaqe ndërtimi 137.7 m², volum 9 faqe 95, në bazë të lejes së legalizimit, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi regjistrimi i pasurisë është kryer duke fshirë të drejtën e pronësisë së shtetit për pasurinë ndërtesë me sipërfaqe totale 98 m², në mungesë të ndonjë akti administrativ apo vendim gjykate të formës së prerë që konfirmon prishjen e objektit në pronësi “shtet”, sa vepruar në papajtueshmëri me pikën 3, neni 34, shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”, i ndryshuar (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 41: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 2/188-Nd, volum 9 faqe 95, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor, lidhur me çregjistrimin e pasurisë nr. 2/188-Nd, volum 9, faqe 95, mbi të cilën është ngritur objekti i legalizuar. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 96, datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë** nr. 2/188-Nd, volum 9 faqe 95, ZK 3224 deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor për fitimin e pronësisë së truallit.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

42- Gjetje: Nga ZVASHK (Ish ZVRPP) Mirditë, gjatë regjistrimit të objekteve ndërtesa të përfutuara me leje legalizimi, rezulton se në asnjë rast nuk ka vendosur kufizim mbi pasurinë ndërtesë, deri në miratimin e kalimit të pronësisë me VKM të parcelës ndërtimore, për të bërë të mundur vendosjen e marrëdhënieve me truallin, duke mos zbatuar kërkesat ligjore të përcaktuara në pikat 16 dhe 14, të VKM nr. 1095/2015 datë 28.12.2015 “Për Përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së dhe të procedurave apo kufizimeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara” (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 42: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë ndërtesa të përfituara me leje legalizimi, deri në miratimin e kalimit të pronësisë me VKM dhe vendosjen e marrëdhënieve me truallin përkatës. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër nr. 97, datë 29.12.2020 sipas të cilit të përfshihet në dokumentacion MP e likuidimit të TNI si dhe certifikata familjare apo certifikata e Gusht 1991.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

43- Gjetje: Nga ish ZVRPP Mirdite janë regjistruar në 6 raste pasuri të përfituara me leje legalizimi, sipas referencave: nr. 1137-1393 dhe 1578, v.3 faqe 249 në emër të F.P.K., nr. 1163-2028, v. 4, faqe 10 në emër të A. N. L., nr. 1680, v. 4, faqe 210 në emër të Y. M. D., nr. 1683-1931, v. 7, faqe 30 në emër të M. N. Gj., nr. 2013-v.7, faqe 175 në emër të Gj. P.M. dhe nr.1959-v. 8, faqe 48 në emër të Sh. M. Z., nga auditimi dokumentacionit rezultoi se për pasuritë e regjistruara nuk ka certifikatë familjare, ndërsa në lejen e legalizimit në pjesën titulli i pronësisë evidentohet shënimi kontratë pronësie e Parcelës ndërtimore, bazuar në VKM por VKM-të përkatëse që kanë miratuar kalimin e pronësisë, nuk rezultojnë të jenë bashkëlidhur dokumentacionit të dosjeve përkatëse, veprime në kundërshtim me pikën 10 të VKM nr. 1095, datë 28.12.2015.

Nuk ka urdhër nga regjistruesi për kryerjen e veprimeve në HTR dhe KPP sipas dokumentacionit dërguar nga AUIZNI Lezhe

Nuk ka relacion hartografik në lidhje me pasurinë e legalizuar, pozicionimin e saj në HTR në ish-ZVRPP. Pasuritë e përfituara nga Ligji i legalizimit janë regjistruar vetëm në emër të njërit subjekt dhe jo sipas certifikatës familjare në zbatim të udhëzimit nr. 4695, datë 31.05.2016, në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 si pasuri e përfitur gjatë martesës, bazuar në regjimin martesor në emër të bashkëshorteve. Në KPP për pasuritë e përfituara me leje legalizimi gjatë regjistrimit nuk rezultojnë të jenë vënë shënimet përkatëse në seksionin “E” hipotekë ligjore, në pritje të VKM-së për miratimin e parcelës ndërtimore, vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshimet përkatëse, VKM nr. 1095, datë 28.12.2015, Udhëzimin nr. 4695, datë 31.05.2016 (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 43: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, të nxjerrë urdhër kufizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit, për pasuritë e regjistruara sipas referencave: nr. 1137-1393 dhe 1578, v.3 faqe 249 në emër të F. P. K., nr. 1163-2028, v.4, faqe 10 në emër të A. N. L., nr. 1680, v. 4, faqe 210 në emër të Y. M. D., nr. 1683-1931, v. 7, faqe 30 në emër të M. N. Gj., nr. 2013-v.7, faqe 175 në emër të Gj. P. M. dhe nr. 1959-v. 8, faqe 48 në emër të Sh. M. Z. dhe në vazhdimësi. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

97, datë 29.12.2020 (ku përfshihen emrat e mësipërme) sipas të cilit të përfshihet në dokumentacion MP e likuidimit të TNI si dhe certifikata familjare apo certifikata e Gusht 1991.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

44- Gjetje: Nga ish-ZVRPP Mirditë sipas referencës nr. 0082, është regjistruar pasuria nr. 49/7, v. 3, faqe 9 me sipërfaqe 1720 m2 (Pyll), që vijon me ndarje nga v. 2, faqe 215, për të cilën nuk ka urdhër për ndarje pasurie. Mbi këtë është regjistruar pasuria nr. 49/7, Godinë shërbimi 3 kat, me sipërfaqe ndërtimi 573.35 m2, sipas lejes së legalizimit nr. 819935, datë 19.04.2017, rezulton se nuk ka shënime në seksionin ”E” për truallin në pritje të VKM së, si dhe nuk është vendosur shënimi, pra regjistrimi i truallit është bërë pa u miratuar VKM-ja përkatëse që miraton kalimin e pronësisë, vepruar në kundërshtim me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 si pasuri e përfutur gjatë martesës, udhëzimin e KM nr. 2, datë 12.09.2012, pika 2, 3, 4, pika 8 për plotësimin e formularit të verifikimit sipas shtojcave 1,2,3 bashkëlidhur udhëzimit (Trajtuar ne faqet 79-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 44: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të përfutura me leje legalizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit dhe miratimin e kalimit të pronësisë me VKM dhe vendosjen e marrëdhënieve me truallin përkatës. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2060) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhër kufizimi nr. 103 datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor për fitimin e pronësisë së truallit.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht

45- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka ofruar shërbimin e kërkuar, në kushtet kur objekti në pjesën më të madhe të tij bie mbi pasurinë nr. 65/4 e llojit ranishte, regjistruar volum 2, faqe 148 me sipërfaqe 815 m2 pronësia shtet, kartela mbyllet shkon volum 2 faqe 153, regjistruar sipas Lejes së Legalizimit nr. 818908, datë 26.01.2011. Objekti “Godinë shërbimi 2 kate”, parcela ndërtimore me sipërfaqe 288 m2, sipërfaqja e ndërtimit 96 m2, ZK 2162. Veprime në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nenin 2 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, me Ligji Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe pikën 3, pikën 4, germa “a”, “dh” dhe “e”, pikën 5 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 45: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 137, volum 2, faqe 153, ZK 2162, Referencë nr. 0107, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2060) dhe nga ana e Përgjegjës të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 104 datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP** deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor .

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

46- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka kryer veprimet në (KPP) seksioni B përshkrimi i pasurisë duke ndryshuar llojin e saj nga ranishte në truall, pa ndjekur procedurën e ndryshimit të kategorisë së tokës. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pikën 5 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 46: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 6/5, volum 2, faqe 144, ZK 2162, Referencë nr. 0109, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2060) dhe nga ana e Përgjegjës të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 105 datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë** nr. 6/5, volum 2, faqe 144, ZK 2162, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

47- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka ofruar shërbimin e kërkuar sipas referencës nr. 024 dhe nr. 015, në kushtet kur në dosje mungon komplet praktika e regjistrimit të lejes së legalizimit, ku rezulton se gjurma e objektit është ndryshuar nga 224,6 m² në 672.3 m². Gjithashtu dokumentacion urbanistik: Formulari nr. 2 dhe nr. 4, leje sheshi dhe leja e ndërtimit nuk janë origjinale. Ne lejen e sheshit sipërfaqja e ndërtimit është 752 m² ndërsa në kartelë 224.6 m². Veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme pika 5 e Udhëzimit nr.2, datë 12.09.2012 dhe pikën 3, pikën 4, germa “a”, “dh” dhe “e”, pikën 5 të VKM nr. 280, date 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” (Trajtuar në faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 47: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, pikës 5.2.2, të kreut të VI, të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 287/2, volum 2, faqe 47, ZK 2186, Referencë 0027/024/015, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2060) dhe nga ana e Përgjegjës të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

kufizimi nr. 106 datë 29.12.2020 dhe regjistruar në KPP për pasurinë nr. 287/2, volum 2, faqe 47, ZK 2186, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

48- Gjetje: ZVASHK Mirditë në 11 raste, sipas referencave: nr. 0584, ka regjistruar pasurinë nr. 99/18, volum 1, faqe 12, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 132 m², me referencë nr. 0589, volum 5, faqe 52, regjistruar pasuria nr. 101/32, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 140 m², me referencë nr. 0708, volum 1, faqe 7, regjistruar pasuria nr. 99/23, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 150 m²; me referencë nr. 0667, volum 2, faqe 126, regjistruar pasuria nr. 114/2, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 132 m², ZK 1666; me referencë nr. 05152, volum 13, faqe 142, regjistruar pasuria nr. 7/165, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 97 m², me referencë nr. 5267, volum 13, faqe 62, regjistruar pasuria nr. 8/335, truall me sipërfaqe 296 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 57 m², me referencë nr. 5268, volum 13, faqe 63, regjistruar pasuria nr. 8/336, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 28 m², me referencë nr. 5268, volum 13, faqe 64, regjistruar pasuria nr. 8/337, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 28 m², me referencë nr. 5685, volum 11, faqe 83, regjistruar pasuria nr. 7/69, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 54 m², me referencë nr. 5251, volum 10, faqe 71, regjistruar pasuria nr. 8/331, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 41.4 m², me referencë nr. 4977, volum 11, faqe 48, regjistruar pasuria nr. 10/5, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 111 m², ZK 3224; Këto pasuri janë përfituar me Vendime të pushtetit vendor, në zbatim nenit 25/ç të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 (kur nuk zotërohen akte pronësie), rezulton se regjistrimi është kryer me shkelje të dispozitave ligjore, pasi:

- Mungon dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë para vitit 1991;
- Vendimet që kanë miratuar kalimin e pronësisë lëshuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, nuk kanë bashkëlidhur dokumentacioni hartografik të miratuar, që evidenton pasurinë objekt kalimi në pronësi, përcaktuar në pikën 8.1, e VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.
- Në të gjitha rastet mungon Vendimi i Këshillit të Qarkut Lezhë, i cili duhet të shprehej në lidhje me vendimin e Bashkisë Mirditë për kalimin e pronësisë truall dhe ndërtesë, përcaktuar në pikën 8.1, e VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.
- Pasuritë e miratuara për kalim pronësie rezultojnë të regjistruara në pronësi “shtet”, në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pra nuk jemi në kushtet e sipas pikës 4/ç, të VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar.

Sa vepruar në papajtueshmëri me germën “ç” neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33/2012 datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 608, datë 05.09.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, të ndryshuar dhe me pikën 5, të VKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*Trajtuar në faqet 92-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 48: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 11 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë, me shkresë nr. 2329, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve verore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje në lidhje me këtë rekomandim të KLSH.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces

49- Gjetje: ZVASHK Mirditë në 1 rast, sipas referencës nr. 5748, ka regjistruar pasurinë nr. 7/32-Nd2, volum 13, faqe 169, ndërtesë me sipërfaqe 85 m², ZK 3224, përfituar me Vendim të pushtetit vendor, në zbatim nenit 25/ç të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 (kur nuk zotërohen akte pronësie), rezulton se regjistrimi është kryer me shkelje të dispozitave ligjore, pasi duke ju referuar të dhënave në KPP volum 7, faqe 117, pasuria nr. 7/32 Nd me sipërfaqe 280 m², rezulton në pronësi “shtet”, ndërsa në seksionin “D” është bërë shënimi “Trashëgimtarët e Ndue Lesh Jakut” kanë të drejtën e parablerjes, sipas VKKP NR. 36, datë 28.07.2006”, në këto kushte Bashkia Mirditë nuk duhet të merrte vendim për kalimin e pronësisë, pasi blerja e objektit duhet të realizohej nga Ministria e Financës, ndërsa ish ZVRPP Mirditë duhet të shqyrtonte hollësisht dokumentacionin e paraqitur dhe nuk duhet të kryente regjistrimin e këtyre 2 akteve, veprim ky në papajtueshmëri me germën “ç” neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33/2012 datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 608, datë 05.09.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e trullit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, të ndryshuar dhe me Vendimin e KKP nr. 36, datë 28.07.2006 (*Trajtuar në faqet 92-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 49: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr.7/32-Nd2, volum 13, faqe 169, ZK 3224, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor. Brenda muajit Shtator 2020.

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020). ZVASHK Mirditë ka nxjerrë urdhrin e kufizimit nr. 110, datë 29.12.2020 regjistruar në KPP nr. 7/32-Nd2, volum 13, faqe 169, ZK 3224, deri në plotësim dokumentacioni ose pagesën e vlerës trullit prej 280 m².

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

50- Gjetje: Nga ish-ZVRPP Mirditë në 8 raste për 8 subjekte, sipas referencave: 1770-1841-1845-1842, v. 4, faqe 73 në emër të Marinela Pepa, nr. 1486-1391, v. 4, faqe 181, në emër të P. P. D., nr. 1486-1898, v. 5, faqe 210 në emër të R. P., nr. 1486-1399, v. 6, faqe 80 në emër të A. C., nr. 1768, v. 8, faqe 205 në emër të V. Gj., nr. 1917, v. 9, faqe 10 në emër të F. P. K., nr. 1774, v. 9, faqe 31 në emër të K. Gj. M. dhe nr. 1773, v. 9, faqe 32 në emër të P. Gj. M., në total është regjistruar një sipërfaqe trulli 1765 m² dhe ndërtimi 589 m², në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, rezulton se regjistrimi është kryer me shkelje të dispozitave ligjore, pasi:

- Mungon dokumentacioni nga arkivi teknik i ndërtimit, që pasqyron hartografisht gjendjen e pasurisë para vitit 1991 dhe nuk ka asnjë dokument tjetër kofirmues (lidhur me ekzistencën e objektit para vitit 1991).

- Dokumentacioni i dosjes dërguar në ZVRPP ka vetëm vendimet origjinale, ndërsa dokumentacioni tjetër shoqëruar është fotokopje dhe nuk ka vulat dhe firmat nga Bashkia për njësimin e dokumentacionit, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM nr. 608, datë 05.09.2012, pika 8.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

- Nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, pasi mungon dokumentacioni konfirmues përkatës që vërteton shlyerjen e detyrimeve financiare, për truallin e përfutur nga 8 subjekte, duke shkaktuar shkelje të disiplinës financiare, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, në vlerën totale 2,800,000 lekë, e pa likuiduar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012.

Sa vepruar në papajtueshmëri me germen “ç” neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33/2012 datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 608, datë 05.09.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, të ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (*Trajtuar ne faqet 92-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 50: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 8 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe deri në arkëtimin e detyrimit financiar nga 8 subjektet në vlerën 2,800,000 lekë. Brenda muajit Shtator 2020

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë, me shkresë nr. 2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirditë ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve vlerën 2,800,000 lekë, duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje ne lidhje me këtë rekomandim të KLSH.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pazbatuar.

51- Gjetje: Ish ZVRPP Mirditë, nuk ka një evidencë dhe nuk njihet e raportohet gjendja e pasurive të regjistruara me mbivendosje, as nuk raportohet ndjekja e procedurave ligjore për trajtimin e pasurive me mbivendosje si dhe nuk raportohet ecuria e zgjidhjes dhe pjesëmarrja e kësaj zyre në seancat gjyqësore për këto çështje. Kjo gjendje vazhdon të jetë për periudhën objekt auditimi 01.01.2016 deri 31.12.2019, çka nënkupton se mosevidentimi i pasurive me mbivendosje vazhdon që prej përpara periudhës së auditimit, pra dhe mos marrjen e masave për krijimin e data-base për evidentimin e pasurive me mbivendosje dhe ecurinë e zbatimit të procedurave ligjore në përputhje me kërkesat e Ligjit 33/2012 datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, Neni 59 dhe 74 (*Trajtuar ne faqet 116-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 51: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrë masa të menjëhershme për krijimin e një data-base për evidentimin e pasurive me mbivendosje, ecurinë e zbatimit të procedurave ligjore për trajtimin e pasurive me mbivendosje si dhe pjesëmarrja e kësaj zyre në seancat gjyqësore për këto çështje. Menjëherë.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhri nr. 107, datë 29.12.2020 sipas të cilit urdhërohet hapja dhe plotësimi i një regjistri të posaçëm për evidentimin rast pas rasti të pasurive rezultuar me mbivendosje.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

52- Gjetje: Procedura administrimit dhe qarkullimit të dokumentacionit, ndër vite nuk është kryer në përputhje me rregullat dhe standardet e përcaktuara, pasi dorëzimi detyrës dhe i dokumentacionit përkatës, nga personat e larguar nga puna nuk dorëzohej me procesverbal, për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

rrjedhje rezultojn se një numër i pa caktuar dosjesh, janë në mungesë dhe nuk gjendeshin në ambientet e punës (Trajtuar ne faqet 117-119, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 52:Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë,të marrin masa dhe të urdhërojnë ngritjen e një grupi pune të posaçëm, për të bërë të mundur evidentimin e praktikave të munguara ndër vite, si dhe të marrë masa që në çdo rast të largimit nga puna të punonjësve, apo ndërrimin e vendit të punës, të dorëzojnë me procesverbal, të gjithë dokumentacionin që ka në administrim.

Në vijimësi.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2060) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë urdhri nr. 108, datë 29.12.2020 sipas të cilit urdhërohet ngritja e grupit të punës, kryerja e inventarizimit mbështetur tek azhurnimi i kryer nga Kompania e Menaxhimit DATEK.

Koment:

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për shpërblim dëmi ekonomik atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

1- Gjetje: ZVASHK(Ish ZVRPP) Mirditë ka regjistruar dhe ka kryer veprime sipas referencës nr. 5435 dhe 5080, për pasurinë nr. 3/39-Nd, volum 12, faqe 21, bazuar në dokumentacionin urbanistik, rezultojn që regjistrimi është kryer me shkelje e parregullsi, pasi ka pasaktësi lidhur me sipërfaqen e katit përdhe që përcaktohet (sipas planimetrisë së katit përdhe) 1390 m², ndërsa në KPP është regjistruar sipërfaqja e ndërtimit 1404.5 m², e cila në fakt nuk i përket katit përdhe, por sipërfaqes së bodrumit(kjo evidente edhe në vendimin për leje shesh ndërtimi), si dhe rezultojn në mungesë të marrëdhënieve me truallin dhe në kushtet e kufizimit, janë kryer veprime duke lëshuar certifikatë pronësie.

Gjithashtu nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Taksave të bashkisë Mirditë, rezultojn se subjekti investitor dhe ndërtues “J. K. 95” shpk, nuk ka shlyer detyrimet financiare që rrjedhin nga miratimi i lejes së ndërtimit, lidhur me shlyerjen e detyrimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, përfshirë edhe penalitetet, nga mos shlyerja e këtij detyrimi rezultojn debitor në shumën 9,419,530 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare, si ardhur e munguar në buxhetin e shtetit dhe të Bashkisë Mirditë, veprime në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, nenin 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruarit” (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Rekomandim 1: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi**, për pasurinë 3/39-Nd, volum 12, faqe dhe pasuritë që rrjedhin prej saj, që janë në pronësi të *subjekti investitor dhe ndërtues* “Jushi Konstruktion 95” shpk, **deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe deri në likuidimin e plotë të detyrimit financiar në shumën 9,419,530 lekë, si debitor për moslikuidim të** taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë në bashkëpunim me Bashkinë Mirditë.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga ana e Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë është nxjerrë **urdhër kufizimi nr. 109, datë 29.12.2020 dhe është regjistruar kufizimi në KPP të** pasuri nr. 3/39-Nd, volum 12, faqe 21, ZK. 3224, (deri në likuidimin e vlerës), është njoftuar Bashkia Rrëshen me shkresë nr. 2329, datë 15.12.2020, për të cilën ende nuk ka një përgjigje nga kjo e fundit. Pra nuk ka një dokument për arkëtimin e vlerës **9,419,530 lekë, si debitor për moslikuidim të** taksës së ndikimit në infrastrukturë

Koment:

Përveç masave për vendosje kufizimit mbi pasurine dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës **9,419,530 lekë TNI**

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar.**

2- Gjetje: ZVASHK Mirditë në **1 rast**, sipas referencave nr. 5267, nr. 5268 dhe nr. 5272, ka regjistruar pasuri të paluajtshme, përkatësisht **nr. 8/335, volum 13, faqe 62**, truall me sipërfaqe 296 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 57 m², **nr. 8/336, volum 13, faqe 63**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 28 m² dhe **nr. 8/337, volum 13, faqe 64**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 28 m², të përfituara me 3 vendimet e Bashkisë Mirditë: nr. 7, datë 19.02.2016; nr. 8, datë 19.02.2016 dhe nr. 9, datë 19.02.2016, ku rezulton se nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, pasi duke ju referuar dokumentacionit ligjor dhe hartografik, rezulton se 3 objektet ndërtesa janë pjesë e të njëjtës ndërtesë, por me hyrje të veçanta për secilën familje, për rrjedhojë kalimi i pronësisë duhet të bëhet për truallin funksional të objektit në tërësi, ndërsa në rastin konkret për një ndërtesë, është miratuar kalimi i pronësisë për 3 troje me sipërfaqe **totale prej 896 m²**, duke miratuar më tepër truallin me sipërfaqe 596 m², që llogaritet në vlerën **2,106,500 lekë** [896(sip. totale tepër)*2351 lek/m²], që përbën shkelje të disiplinës financiare, me efekt ekonomik të pa arkëtuar në buxhetin e shtetit, vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore përcaktuar në nenin 25/ç, të ligjit nr. 33/2012 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 608, datë 05.09.2012 (Trajtuar ne faqet 92-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 2: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë nr. 8/335, volum 13, faqe 62 dhe nr. 8/336, volum 13, faqe 63**, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor për fitimin e pronësisë dhe shlyerjen e detyrimit financiar në vlerën **2,106,500 lekë, si vlerë e truallit të përfitur me sipërfaqe 596 m².**

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë, me shkresë nr. 2329, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve verore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje në lidhje me këtë rekomandim të KLSH. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me **urdhrin me rezerve nr. 110, datë 29.12.2020** regjistruar në KPP nr. 7/32-Nd2, volum 13, faqe 169, ZK 3224, deri në plotësim dokumentacioni ose pagesën e vlerës truallit prej 280 m².

Koment:

Përvec masave për vendosje kufizimit mbi pasurinë dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës **2,106,500 lekë**, të truallit me VKM 608

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

3- Gjetje: ish ZVRPP Mirditë në 73 raste ka regjistruar pasuri të paluajtshme, të përfituara me Leje legalizimi (sipas informacionit të marrë nga Bashkia Mirditë), **rezulton se nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, pasi mungon dokumentacioni konfirmues përkatës që vërteton shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga taksa e ndikimit në infrastrukturë**, duke shkaktuar **shkelje të disiplinës financiare, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, në vlerën totale 2,028,600 lekë**, e pa likuiduar, nga subjektet, pasqyruar më hollësisht në tabelën **"Detyrimet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë"**, bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit.

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 3: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, në bashkëpunim me Sektorin e ALUIZNI-t Lezhë dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimit financiar **në vlerën totale 2,028,600 lekë**, sipas tabelës **"Detyrimet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë"**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe Përgjegjësit të ZVASHK Mirditë, me shkresë nr. 2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve verore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje në lidhje me këtë rekomandim të KLSH. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me **urdhrin me rezerve nr. 111, datë 29.12.2020** regjistruar në 73 KPP e pasurive me leje legalizimi të listuara, deri pagesën e vlerës **totale 2,028,600 lekë** takse ndikimi në infrastrukturë.

Koment:

Përvec masave për vendosje kufizimit mbi pasurinë dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës totale **2,028,600 lekë**, takse ndikimi në infrastrukturë.

Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar**

4- Gjetje: ZVASHK Mirditë në 8 raste ka regjistruar pasuri të paluajtshme, të përfituara me vendime të Bashkisë Mirditë, **rezulton se nuk janë zbatuar kërkesat ligjore, pasi mungon dokumentacioni konfirmues përkatës që vërteton shlyerjen e detyrimeve financiare**, për truallin e përfitur, duke shkaktuar **shkelje të disiplinës financiare, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, në vlerën totale 3,600,000, lekë**, e pa likuiduar, nga subjektet, si më poshtë:

- **N. D. R. dhe 2 bashkëpronarët**, sipas referencës 0584, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 99/18, volum 1, faqe 12**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 132 m², ZK 1666, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin e përfitur, në vlerën **400,000 lekë**;

- **F. Z. K. dhe 4 bashkëpronarët**, sipas referencës 0589, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 101/32, volum 5, faqe 52**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 140 m², ZK 1666, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin e përfitur, në vlerën **400,000 lekë**;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

- **Ll. N. dhe 5 bashkëpronarët**, sipas referencës 0667, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 114/2, volum 2, faqe 126**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 132 m², ZK 1666, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin e përfutur, në vlerën **400,000 lekë**;
 - **N. D. R. dhe 2 bashkëpronarët**, sipas referencës 5152, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 7/165, volum 13, faqe 142**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 97 m², ZK 3224, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin e përfutur, në vlerën **400,000 lekë**;
 - **T. B., Z. B. dhe Gj. B.**, sipas referencës 5267, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 8/335, volum 13, faqe 64**, truall me sipërfaqe 296 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 57 m², ZK 3224, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin e përfutur, në vlerën **400,000 lekë**;
 - **N. N. T. dhe 8 bashkëpronarët**, sipas referencës 5684 dhe 5685, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 7/68, volum 8, faqe 173**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 85 m² dhe pasuria nr. **pasurinë nr. 7/69, volum 11, faqe 83**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 54 m², ZK 3224, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin(2 troje) e përfutur, në vlerën **800,000 lekë (400,000+400,000)**;
 - **P. Gj. R. dhe 3 bashkëpronarët**, sipas referencës 5251, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 8/331, volum 10, faqe 71**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 41.4 m², ZK 3224, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin e përfutur, në vlerën **400,000 lekë**;
 - **M. N. H. dhe 3 bashkëpronarët**, sipas referencës 4977, regjistruar në KPP pasuria nr. **pasurinë nr. 10/5, volum 11, faqe 48**, truall me sipërfaqe 300 m² dhe ndërtesë me sipërfaqe 111 m², ZK 3224, për mos shlyerje të detyrimit financiar për truallin e përfutur, në vlerën **400,000 lekë**;
- Sa trajtuar, **vepruar** në papajtueshmëri me germën “ç” neni 25, të ligjit nr. 33/2012 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar dhe pikën 8, të VKM -së nr. 608, datë 05.09.2012, të ndryshuar (Trajtuar ne faqet 92-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 4: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, **bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e sipërcituara në 8 raste**, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në shlyerjen e detyrimit financiar në vlerën **3,600,000 lekë**, si dhe të bashkëpunojë me institucionet e Pushtetit Vendor, për të konfirmuar rast pas rasti likuidimin e detyrimeve financiare. **Brenda muajit Shtator 2020.**

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga Përgjegjësi i ZVASHK Mirditë, me shkresë nr. 2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve verore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje në lidhje me këtë rekomandim të KLSH. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me urdhrin me rezerve nr. 112, datë 29.12.2020 regjistruar në 8 KPP-të përkatëse deri në plotësim dokumentacionit ose pagesën e vlerës truallit prej **3,600,000 lekë**, përfutur sipas VKM 608

Koment:

Përvec masave për vendosje kufizimit mbi pasurine dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës **3,600,000 lekë**, të truallit me VKM 608

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

5- Gjetje: Ish/ZVRPP Mirditë ka kryer veprime në kushtet kur: Leja e shfrytëzimit nuk është nënshkruar nga kryetari i autoritetit përgjegjës që ka lëshuar lejen, nuk është bërë rillogaritja e diferencës që del nga vlera e objektit sipas preventivit dhe vlerës faktike të punimeve, duke krijuar një diferencë të pa likuiduar nga subjekti në vlerën 160,706 lekë {[23,970,620(vlera sipas punimeve faktike)-15,934,720 lekë(vlera sipas preventivit)]*0.02}.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 45 të Ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme pika 5 e Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012, nenin 2 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, ligjin nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, dhe pikën 3, pikën 4, germa “a”, “dh” dhe “e”, pikën 5 të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”. (Trajtuar ne faqet 64-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 5: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 149/3, volum 2, faqe 12, ZK 2125, Referencë nr. 076/056, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe likuidimin e detyrimit financiar në vlerën 160,700 lekë, si diferencë e papaguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga Përgjegjësi i ZVASHK Mirditë, me shkresë nr.2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve vlerore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje ne lidhje me këtë rekomandim të KLSH. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me urdhrin me rezerve nr. 113, datë 29.12.2020 regjistruar në KPP nr. 149/3, volum 2, faqe 12, ZK 2125, deri në plotësim dokumentacionit ose pagesën e vlerës 160,700 lekë, si diferencë e papaguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Koment:

Përveç masave për vendosje kufizimit mbi pasurinë dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës vlerës 160,700 lekë, si diferencë e papaguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

6- Gjetje: Nga ish-ZVRPP Mirditë sipas referencës nr. 0080, është regjistruar pasuria 76/2, v. 3, faqe 7 me sipërfaqe 689.7 m² tokë (shkëmbore) që vijon nga v. 2, faqe 18 me ndarje dhe ka vijuar në p.76/1, v1, faqe 6 për sipërfaqen prej 10800 m² zëri shkëmbore(shtet), ndërsa diferenca prej 600 m² nuk rezulton të jetë evidentuar në KPP. Mbi këtë është regjistruar sipas lejes së legalizimit nr. 818905, datë 26.01.2017, godinë shërbimi 1 kat me sipërfaqe ndërtimi 229.89 m². Nuk janë vendosur shënimet në KPP seksioni E për truallin në pritje të VKM, dhe regjistrimi i lejes së legalizimit është bërë në kundërshtim me nenin 41 të ligjit 33/2012 pika 2. Gjithashtu pas kryerjes së transaksionit për këtë pasuri nuk rezulton të jete llogaritur tatimi 15 % në vlerën 156,658 lekë (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 6: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 76/2, v. 3, faqe 7 Referencë nr. 0080, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe likuidimin e detyrimit financiar në vlerën 156,600 lekë, si diferencë e papaguar për tatimin e tjetërsimit të pasurisë.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga Përgjegjësi i ZVASHK Mirditë, me shkresë nr.2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve vlerore duke



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

*listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje në lidhje me këtë rekomandim të KLSH. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me **urdhër kufizimi nr. 70, datë 29.12.2020**, regjistruar në KPP pasurisë nr. 76/2, v. 3, faqe 7 deri në plotësim dokumentacionit dhe dhe likuidimin e detyrimit financiar në vlerën **156,600 lekë**, si diferencë e papaguar për tatimin e tjetërsimit të pasurisë.*

Koment:

*Përveç masave për vendosje kufizimit mbi pasurine dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës **156,600 lekë**, si diferencë e papaguar për tatimin e tjetërsimit të pasurisë.*

*Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar***

7- Gjetje: Nga ish-ZVRPP Mirditë sipas referencës nr. 0084, sipas lejes së legalizimit nr. 811020 datë 24.04.2017 është regjistruar pasuria nr. 49/9-ND, v. 3, faqe 12, godinë shërbimi 1 kat me sipërfaqe 733.6 m² dhe sipas lejes së lejes së Legalizimit nr. nr. 811019, datë 24.04.2017, është regjistruar pasuria nr. 49/11-ND v.3, faqe 15, ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 245 m², proceduarat e regjistrimit janë kryer me parregullsi, pasi:

- Nuk është vendosur kufizimi në seksionin E, për pasuritë ndërtesa, deri në miratimin e trullit me VKM, **vepruar në kundërshtim** me nenin 41, pika 2 e ligjit nr. 33, date 29.04.2012 si pasuri e përfituar gjatë martesës, udhëzimin e KM nr. 2, datë 12.09.2012.

- Poseduesi i lejeve të legalizimit rezulton se ka legalizuar më shumë se një ndërtim, duke mos ju llogaritur pagesa për taksën e ndikimit në infrastrukturë me çmime jo favorizues, për rrjedhojë është shmangur detyrimi financiar në vlerën **2,055,000 lekë [51,399,600 lekë (vlera e ndërtesës)*0.04 (taksa e ndikimit në infrastrukturë)]**, **vepruar në kundërshtim** me nenin 25, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar (Trajtuar në faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 7: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, që në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, **bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 49/9-ND, v. 3, faqe 12 Referencë nr. 0084, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe likuidimin e detyrimit financiar në vlerën 2,055,000 lekë**, si diferencë e papaguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

*Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga Përgjegjësi i ZVASHK Mirditë, me shkresë nr.2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve vlerore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje në lidhje me këtë rekomandim të KLSH. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me **urdhër kufizimi nr.70, datë 29.12.2020** regjistruar në KPP pasurisë nr. 49/9-ND, v. 3, faqe 12, dhe pasurisë 49/11-ND v.3, faqe 15 deri në plotësim dokumentacionit dhe likuidimin e detyrimit financiar në vlerën **2,055,000 lekë** taksë ndikimi në infrastrukturë.*

Koment:

*Përveç masave për vendosje kufizimit mbi pasurine dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës **2,055,000 lekë** taksë ndikimi në infrastrukturë*

*Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar dhe i zbatuar***

8- Gjetje: Nga ish ZVRPP Mirdite nr. 075, datë 28.01.2016, regjistruar nr. 75/2, v.2, faqe 207 me sipërfaqe gjithsej 2131 m², nga e cila trull 2131 m² dhe ndërtim 200 m² –Autogril-



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

Kompleks Shërbimesh, Karburant Hoteleri sipas lejes ndërtimit dhe lejes së sheshit nr. 1, datë 12.08.2011 me sipërfaqe sheshi 2131 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 1034 m² dhe lëshuar certifikatë me datë 18.2.2016 dhe nga auditimi rezultoi mos llogaritje e taksës së ndikimit në Infrastruktura 4% në lidhje me diferencën e vlerës situacionit dhe vlerës së preventivi dhe nga llogaritja rezultoi një vlerë për tu arkëtuar e pa llogaritur më pare për **prej 1,097,300 lekë (27,434,400*0.04). (Trajtuar ne faqet 79-92, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 8: Zyra Vendore ASHK Mirditë(ish-ZVRPP), Përgjegjësi i Zyrës të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë e regjistruara në emër të Gj. N. T. sipas referencës nr. 0075, të përfituara nga Ligji i Urbanistikës nr. 8405, datë 17.09.1998 me ndryshimet e mëvonshme deri në arkëtimin e detyrimit të përcaktuar nga llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukture në vlerën prej 1,097,300 lekë (27,434,400*0.04). Brenda muajit Shtator 2020.

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga Përgjegjësi i ZVASHK Mirditë, me shkresë nr.2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirdite ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve vlerore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje në lidhje me këtë rekomandim të KLSH. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me urdhër kufizimi nr.91, datë 29.12.2020 regjistruar në KPP pasurisë nr. 75/2, v.2, faqe 207 deri në plotësim dokumentacionit dhe likuidimin e detyrimit financiar në vlerën 1,097,300 lekë taksë ndikimi në infrastrukture

Koment:

Përvec masave për vendosje kufizimit mbi pasurine dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës 1,097,300 lekë taksë ndikimi në infrastrukture

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar

9- Gjetje: Nga ish-ZVRPP Mirditë në 8 raste për 8 subjekte, sipas referencave:1770-1841-1845-1842, v. 4, faqe 73 në emër të Marinela Pepa, nr. 1486-1391, v. 4, faqe 181, në emër të P. P. D., nr. 1486-1898, v. 5, faqe 210 në emër të R. P., nr. 1486-1399, v. 6, faqe 80 në emër të A. C., nr. 1768, v. 8, faqe 205 në emër të V. Gj., nr. 1917, v. 9, faqe 10 në emër të F. P. K., nr. 1774, v. 9, faqe 31 në emër të K. Gj. M. dhe nr. 1773, v. 9, faqe 32 në emër të P. Gj. M., në total është regjistruar një sipërfaqe **trualli 1765 m² dhe ndërtimi 589 m²**, në zbatim të VKM nr. 608, datë 05.09.2012, rezulton se regjistrimi është kryer me shkelje të dispozitave ligjore, pasi mungon dokumentacioni konfirmues përkatës që vërteton shlyerjen e detyrimeve financiare, për truallin e përfutur nga 8 subjekte, duke shkaktuar shkelje të disiplinës financiare, si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, në vlerën totale 2,800,000 lekë, e pa likuiduar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara nga VKM 608, datë 05.09.2012.

Sa vepruar në papajtueshmëri me germën “ç” neni 25, nenin 45, të ligjit nr. 33/2012 datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, VKM nr. 608, datë 05.09.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, të ndryshuar dhe me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 (Trajtuar ne faqet 92-116, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi i lënë

Rekomandim 9: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

kufizimi për pasuritë në 8 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në arkëtimin e detyrimit financiar nga 8 subjektet në vlerën 2,800,000 lekë, të analizuara, si më poshtë:

1. M. P.	vlera 200.000 lekë
2.P. D.	“400,000 lekë
3.R. P.	“400,000 lekë
4.A. C.	“300,000 lekë
5.V. Gj.	“300,000 lekë
6.F. K.	“400,000 lekë
7.K. M.	“400,000 lekë
8.P. M.	“400,000 lekë

Brenda muajit Shtator 2020

Përgjigja e subjektit:

Ky rekomandim, është pranuar me shkresën nr. 1422, datë 22.6.2020 (prot hyrje KLSH nr. 900/12, datë 26.6.2020) dhe nga Përgjegjësi i ZVASHK Mirditë, me shkresë nr.2329, datë 15.12.2020 i është kërkuar Bashkisë Mirditë(per NJA Rubik) ndjekja dhe arkëtimi i gjithë detyrimeve verore duke listuar me emra për të gjitha rastet e debitorëve. Nga bashkia ende nuk ka një përgjigje ne lidhje me këtë rekomandim të KLSH-së. ZVASHK Mirditë ka nxjerrë me urdhrin me rezerve nr.114, datë 29.12.2020 regjistruar në 8 KPP-të përkatëse deri në plotësim dokumentacionit ose pagesën e vlerës trualit prej 2,800,000 lekë, përfituar sipas VKM 608.

Koment:

Përvec masave për vendosje kufizimit mbi pasurine dhe njoftim të Bashkisë ende nuk ka një dokument mandat arkëtimi nga bashkia në likuidim të vlerës 2,800,000 lekë, të trualit me VKM 608.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar.

6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga verifikimi i korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK rezultoi se nuk është marrë asnjë masë disiplinore për punonjësit të konstatuar si përgjegjës për shkeljet e konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, përkatësisht 2 masa disiplinore (1 masë “Ndërprerje marrëdhënie pune” dhe 1 masë “Vërejtje”) për punonjësit e ZVASHK Mirditë.

IV.KONKLIZIONI I AUDITIMIT

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Mirditë për periudhën 01.01.2016 deri me 31.12.2019, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht, pjesërisht dhe në proces zbatimi, është në nivelin 85%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 52 masa organizative, 9 masa të ardhura të munguara në vlerën 23,424,200 lekë dhe 2 masa disiplinore (“Vërejtje” dhe “Largim nga puna”).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 52 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 40 rekomandime, zbatuar pjesërisht 1 rekomandim, në proces zbatimi 3 rekomandime, janë ezauruar si pasojë e ndryshimeve ligjore 3 rekomandime, si dhe janë pazbatuar 5 rekomandime.

Për të ardhura të munguara janë lënë 9 rekomandime në vlerën 23,424,200 lekë (pranuar të gjitha për të cilat janë vendosur kufizimet përkatëse, por nuk është likuiduar detyrimi nga asnjë subjekt).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

RAPORT PËRFUNDIMTAR "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020"
NË ZVASHK MIRDITË

Janë lënë 2 masa disiplinore të cilat nuk janë zbatuar nga Drejtori i Përgjithshëm ASHK asnjë prej tyre.

V. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr.900/8, datë 19.05.2020, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

Rekomandim 2: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë të marrë masa, bazuar në shkeljet e konstatuara, të bëjë të diferencën dokument-fakt, duke kaluar në pronësi shtet sipërfaqen e tepërt prej 1037 m², në kundërt të vendoset kufizim deri në eliminimin e shkeljeve të konstatuara për pasuritë: volum 7, faqe 204, pasuria nr. 6/29, truall me sipërfaqe 9191 m², e cila mbyllet ndahet në volum 8, faqe 78-80 dhe volum 7, faqe 205, pasuria nr. 6/59, truall me sipërfaqe 7272 m², e cila mbyllet e ndahet në volum 8, faqe 81-83.

Rekomandim 4: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara sipas: AMTP-së nr. 85, referencë nr. 0617, AMTP-së nr. 88, referencë nr. 615, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.2004, referencë nr. 0603, referencë nr. 669, AMTP-së nr. 123, datë 06.07.1993, referencë nr. 580, AMTP-së nr. 61, referencë nr. 632, AMTP-së nr. 62, referencë nr. 0655, ZK 1666, deri në veçimin e regjistrimit në pronësi "shtet", të sipërfaqes së përfituar padrejtësisht, në zbatim të procedurave të përcaktuara në VKM nr. 994, datë 9.12.2015 i ndryshuar.

Rekomandim 7: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e përfituara me AMTP nr. 60, datë 01.02.2002, me posedues Dava Reçi, ZK 1666, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 12: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për saktësimin e sipërfaqeve të pasurive të regjistruara, evidentuara në pasqyrën në pasqyrën nr. 1, më parë se të kryhen transaksione sipas AMTP nr. 20(105) dhe referencës nr. 0039, AMTP 53 -54, AMTP 95 dhe referencës 0092, AMTP 2 dhe referencës 079, AMTP 72 dhe referencës 087, AMTP 66 dhe referencës 086, AMTP 7, AMTP nr. 114 dhe referencës 0191, AMTP 94 dhe sipas AMTP 93, bazuar në VKM nr. 994, datë 09.12.2015.

Rekomandim 13: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë, të marrë masa që në bazë të pikës 1 dhe 4 të nenit 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2014 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e regjistruara, sipas LN, të evidentuara në pasqyrën nr. 1, për 9 raste me sipërfaqe total 10441 m², përkatësisht sipas AMTP 95 800 m², sipas AMTP 66 222 m², sipas AMTP 7 1339 m², sipas AMTP 6 1081 m², sipas AMTP 114 dhe ref. 0191 272 m², sipas AMTP 94, 946 m², sipas referencës nr. 0074 1441 m², sipas AMTP nr. 55-dhe 64 për diferencën e përfituar sipas LN për 574 m² dhe sipërfaqen 1201 m² përfituar me AMTP 64, dhe sipas referencës 0072 për sipërfaqen 2565 m² përfituar me LN dhe jo sipas dokumentacionit ligjor AMTP, deri në plotësimin e dokumentacionit të duhur ligjor për pasuritë.

Rekomandim 44: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 "Për Kadastrën",



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2020”
NË ZVASHK MIRDITË

bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë të përfituara me leje legalizimi, deri në plotësimin e dokumentacionit dhe miratimin e kalimit të pronësisë me VKM dhe vendosjen e marrëdhënieve me truallin përkatës.

Rekomandim 48: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 11 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Rekomandim 50: Përgjegjësi i Zyrës Vendore ASHK Mirditë dhe DVASHK Lezhë, të marrin masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27, të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë në 8 raste, të regjistruara sipas referencave përkatëse, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor dhe deri në arkëtimin e detyrimit financiar nga 8 subjektet në vlerën 2,800,000 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqe 7-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: ZVASHK Mirditë në bashkëpunim me DVASHK Lezhë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë, për rekomandimet e pazbatuara të marrë masa për zbatimin e tyre, ndërsa për rekomandimet e evidentuara që janë zbatuar pjesërisht apo në proces zbatimi, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

VI. LISTA E DOKUMENTAVE TË AUDITIMIT

1. Akt-verifikimi nr. 1, datë 26.02.2021, mbajtur në ZVASHK Mirditë

Shënim: Pas hartimit të Projektraportit të auditimit mbi bazën e dokumentave të mësipërme dhe përcjelljes së tij, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione, prandaj bazuar sa sipër hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit